



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Nr. 001/060 – 158400

Më: 19 dhjetor 2024

PROCESVERBALI

Nga mbledhja XII/2024 e rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 19 dhjetor 2024, filluar nga ora 10:00, në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Në fillim të mbledhjes ishin të pranishëm 30 anëtarë të Kuvendit të Komunës, u bashkëngjitën edhe anëtarë të tjerë.

Të pranishëm në mbledhje ishin edhe Kryetari, Nënkryetari dhe Drejtorët Komunal.

Po ashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, OSBE-ja dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

<https://www.youtube.com/watch?v=5uFqqJ0oJLk> - Pjesa 1

https://www.youtube.com/watch?v=NikA_DMYS9Y – Pjesa 2

https://www.youtube.com/watch?v=ThSbt_CtMZ0 – Pjesa 3

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë të nderuar anëtarë të kuvendit, të nderuar drejtorë të ekzekutivit, shumë i nderuar nënkryetar i komunës, i nderuar zëvendëskryesues, media, gjithë ju të pranishëm, përshëndetje për të gjithë. Siç jeni të njoftuar, për sot e kemi thirrur mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe pas mbledhjes së mbajtjes së Komitetit për Politikë dhe Financa është rekomanduar ky rend dite. Prezent jemi 30 anëtarë kështu që mund të vazhdojmë me punimet e kësaj mbledhjeje. Rendi i ditës për sot është ky:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të datës 31 tetor 2024 (mbledhje e rregullt) dhe 13 nëntor 2024 (mbledhje e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të objektit pronë komunale për raste të veçanta;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2025.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e raportit të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore 2024-2026;
10. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm “Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit” sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, sipas kërkesës së MMPHI-së.

Këto pra ishin pikat e rendit të ditës të përgatitura për sot, po fillojmë menjëherë me pikën e parë.

Pika e parë:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të datës 31 tetor 2024 (mbledhje e rregullt) dhe 13 nëntor 2024 (mbledhje e rregullt);

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Sa i përket procesverbaleve, a ka dikush diçka me shtuar? Në qoftë jo, atëherë po e hedhim në votim, prezent jemi. Po zotëri Quni, te procesverbalet jemi.

Shukri Quni (NISMA): Jo unë nuk e kam te procesverbalet, e kam te rendi i ditës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): T'i përfundojmë procesverbalet edhe kalojmë te rendi i ditës.

Shukri Quni (NISMA): U kry, thash mos po e qet në votim rendin e ditës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jo jo procesverbalet vetëm mandej te rendi i ditës. Zoti Thaçi të lutem mikrofonin nëse ka mundësi me e ndal. Atëherë jemi te procesverbalet, prezent jemi 30 anëtarë. Kush është për që të miratohen procesverbalet? Ju lutem dorën pak më lart për shkak të që t'i numërojmë më saktë? 29 jemi për, zero kundër, zero abstenim. Atëherë miratohen procesverbalet. Ju faleminderit. Tani kalojmë te pika e dytë.

Pika e dytë:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Zoti Quni e ka kërkuar fjalën, pastaj edhe drejtori.

Shukri Quni (NISMA): Faleminderit kryesuese, përshëndetje kolegë kuvendarë, përshëndetje të pranishëm. Unë në emër të partisë që e përfaqësoj këtë partisë Nisma Socialdemokrate, kërkoj që pika e rendit të ditës, domethënë numër tetë, shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik, sot të largohet kjo pikë. Është mirë, nuk kam kërkuar asnjëherë me u larguar pika të tilla prej kuvendit, por në bazë e kërkesës e banorëve, është fjala për një deponi aty, që sot kjo pikë mos të diskutuhet fare por të hiqet nga rendi i ditës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Quni. Drejtori fjalën e ka.

Çelë Lamaj (Drejtore e DSHP-së): E nderuara kryesuese, të nderuar kuvendarë, kolegë drejtor, Nënkryetar i Komunës, të nderuar qytetarë të komunës së Prizrenit. Ne para disa ditësh kemi komunikuar me hartuesin e planit zhvillimor komunal ku ju ka dhënë detyrë që të na gjendet një lokacion edhe për deponinë e inerteve, por gjithsesi edhe për shumë lokacione të tjera ku mund të bëhet grumbullimi i përshtatshëm, sepse e dimë se kemi shumë deponi ilegale në territorin e

komunës së Prizrenit. Kështu që kishte me qenë mirë me i gjet na me plan zhvillimor lokacione të tilla që të jenë të kontrollume, pastaj me kompaninë përgjegjëse për largimin e atyre dhe dërgimin në deponinë qendrore në Landovicë të kryhet në këtë formë. Prandaj edhe ne si kërkues, iniciues kësaj pike të rendit ditës kërkojmë tërheqjen e kësaj pike të rendit ditës dhe vendosjen e një pike një pike tjetër të rendit ditës, Dje pas dite më ka ardhur një informacion i cili kemi diku afër 200 hektar tokë në Serbicë e Poshtme dhe të Epërme që sipas informacioneve që kam duhet të futen në listën e privatizimit. Edhe për këtë arsye tash po ju shpërndahet materialit, ka qenë kjo urgjencë që komunës së Prizrenit kjo sipërfaqe i duhet shumë, i duhet për implementimin e një qendre rekreativo-sportive. Ne e dimë se qyteti jonë, Prizreni ka pak hapësira të veta edhe nuk ka hapësira të tilla që mund të zhvillohen aktivitete siç tash parashihen edhe lojnat mediterane edhe një stadion i tillë i qytetit të Prizrenit ku është planifikuar nuk i plotëson kriteret e asat te UEFA-as, as standarte të tjera që është një stadion i cili nuk mundet me i plotësu kriterin e nivelit të dytë të cilin e kërkon UEFA. Prandaj, ne si komunë është me interes shumë të madh që këtë hapësirë prej 200 hektarësh ta zhvillojmë në një qendër të madhe rekreativo-sportike ku aty mund të ketë edhe stadion, mund të ketë edhe fusha e tenisit dhe rekreacionet e tjeram të gjitha ato që kanë lidhje me sportin mund të vendosen në një sipërfaqe të tillë. Andaj nga ju kërkojmë që Kryetari i Komunës për vërtetimin i interesit të përgjithshëm shoqëror të patundshmërisë si pasuri shoqërore të cilat janë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit me pronar Kombinat Progres me numër të ngasrës katastrale 464-30 zona katastrale e Serbicë e Epërme. Vetëm pjesa ideale të kësaj ngastri domethënë 1150913, në një superfaqe prej 1160701 m², domethënë nja 116 hektar është kjo ngastër dhe ngastra katastrale KBI Progres Prizren 670-1 zonë katastrale Serbicë e Poshtme vetëm pjesë ideale e kësaj ngastre 2055 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 104 hektar e 793 ari apo 147993 m². Për këtë arsye këto parcela në të ardhmen është paraparë që komuna e Prizrenit t'i shfrytëzoj pra për një qendër rekreativo-sportive. Dijeni që në të ardhmen komuna e Prizrenit ka me pasur mundësi ta hartojë një projekt, domethënë ka kapacitete për hartimin e një projekti në tërë këtë sipërfaqe e ndoshta pastaj me donacione apo me ndonjë grand qeveritar për interesin jo vetëm Prizrenit po kjo qendër mund ta shfrytëzoj tërë territori i Republikës së Kosovës. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor për propozimet. Po zotër Thaqi fjalën e ka.

Islam Thaqi (LVV): Faleminderit kryesuese. Fillimisht e mbështes kërkesën e kolegut kuvendar zotëri Shukri Quni dhe njëkohësisht një vërejtje për ekzekutivin. Për shkak se problemi i deponive është problem thuajse dekadën e fundit në komunën e Prizrenit. Nuk mundet me u hartuar një plan zhvillimor e mos të ketë parashikime për veprime të tilla. Do të thotë, në qoftë se kërkesa ka qenë që të krijohet një deponi në zonën katastrale në fshatin Billushë e në cilindo tjetër lokacion ajo duhet të jetë e përfshirë në planin zhvillimor komunal. Do të thotë ne këtu po vijmë thuajse para akteve të kryera, do të thotë kur diçka nuk është në planin zhvillimor e ne pastaj me vendime të veçanta mendohe mi me i futë. Drejtor, sinqerishti s'pata ndërmend me fol për shqetësimin që ngritët, mirëpo qekjo tash që e bëtë. A është kërkesë për futjen në rend të ditës apo? Po dje e keni pasur bre apo pardje, kur ka qenë KPF-ja? A din deri kur këto praktikant në minuta të fundit me futë një pikë edhe me na qit në dyshim edhe lajthitje, qe po ndodh diçka e që nuk është në interes të përgjithshëm. Keni pasur mjaftueshëm kohë edhe jam kundër futjes së kësaj në rend të ditës për shkak se lyp një vlerësim edhe analizë bukur mirë të detajuar. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Thaqi. Kryetar mirëse erdhët në mbledhjen e Kuvendit. Dikush tjetër a ka rreth rendit të ditës? Po Selmani fjalën e ka.

Selman Sokoli (LVV): Gjatë fjalës së drejtorit, domethënë u thanë disa pasaktësi ose disa tendenca me u devijuar çështja. E para, Prizreni ka një stadium dhe ai stadium do të jetë në bazë

të standarteve, për atë tash është hartuar projekti dhe janë dhënë 13 milion euro drejtor, omethënë nëse nuk e keni kuptuar deri tash, nëse jeni izoluar në këtë vorbollën tuaj. E dyta, qysh ndodhi ju pasi AKP-ja po don me privatizuar një provë, juve ju kujtua në momente të fundit se e paskët një projekt shumë të madh që ai projekt paska me lulëzu Prizrenin. Ama ju ka kujtu juve që ai projekt i madh...

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Selman, a ki konkrete diçka për rendin e ditës ndonjë propozim me e shtuar apo me heq diçka? Te rendi i ditës jemi.

Selman Sokoli (LVV): A bëjmë seancën po, jo edhe përfundon.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dëgjo, mandej e kemi pikën çështjet e ndryshme.

Selman Sokoli (LVV): Po për rendin e ditës jam tu fol.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po të lutem sa më shkurtë.

Selman Sokoli (LVV): Domethënë në kuadër të rendit i ditës është kjo. Domethënë po tentohet me u kontrabanduar një pikë që nuk i kemi të dhënat, tash na erdh materiali. Ju jeni trikagji të fortë ndoshta e studioni shpejtë minutash, mirëpo neve na duhet kohë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit.

Selman Sokoli (LVV): Kryesuese, unë po them që nuk kemi nevojë me e futë këtë, nëse është me të vërtetë në interes të komunës, e shqyrtoj.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Mirë, ka qenë propozim.

Selman Sokoli (LVV): Nëse komuna paska pasur projekt, qysh e kuptoj komuna kur doli prona në privatizim, qysh e kuptoj që është projekt? Edhe mos hajdeni këtu me gënjy, me mashtruar njerëz që Prizreni nuk ka stadium, Prizreni ka stadium, i kanë nda 13 milion euro për me me renovuar stadiumin. Apo po do me i bë kashillok tash qeverisë qëndrore me kesi gjëra.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faliminderit Selman se po presin edhe të tjerët. Zotëri Qemal fjalën, pastaj Petritin. Drejtor mandej ju japim fjalën edhe juve.

Qemal Krasniqi (LDK): Faliminderit Kryesuese. Përshëndetje kolegë kuvendar, përshëndetje drejtor dhe të gjithë të pranishëm. Gjithashtu edhe grupi i kuvendarëve të LDK-së mbështesin propozimin e zotit Quni. Gjithashtu deshta të kyqem pak rreth propozimit të drejtorit që na dha. Ne konsiderojmë që ky është propozim shumë me vend, sepse ajo pjesë në qoftëse e dinë kolegët e ka një afër deponitë e mbeturinave është në Landovicë, nuk është shumë afër por aty diku, dhe ajo pjesë ka nevojë për një qendër rekreative. Janë shumë hektarë është shumë e vërtetë kjo, dhe Prizreni si qytet ka nevojë, sidomos për një stadion me përmasa ndërkombëtare, sepse është vend ideal që lidh Suareken, Prizrenin dhe Rahovecin. Është një vend strategjik për këtë lloj që e bëri propozimin edhe drejtori. Sa i përket stadionit të qytetit ku aktualisht gjendet, ky stadion vendin nuk e ka që me u ndërtuar diçka më mirë, është fakt që diku 13 milionë parashihen investime, mirëpo realisht 13 milionë me u investuar në atë pjesë ku aktualisht gjendet stadioni, nuk është mirë. Sepse është shumë pare dhe Prizreni mundet me ndërtuar një stadion aty ku po parashihet kjo qendër rekreative dhe do të na kanë lakmi edhe të tjerët. Me një fjalë, ne si grup i kuvendarëve të LDK-së, këtë propozim të mirë e përkrahim. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Krasniqi, po Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (GUXO): Faleminderit kryesuese. E mbështes edhe unë personalisht kërkesën e zotëri Shukriut, sepse unë jetoj në atë pjesë dhe e di që njëherë për njëherë është e dëmshme kjo parcellë të cilën është shfrytëzuar do të thotë për këtë deponi dhe ju është ndryshuar destinimi i kësaj. Shpresoj që në fillim të vitit të ardhshëm të vihet në kuvend dhe të ndryshohet lokacioni sepse ajo deponi përpos që i bën dëm fshatrave Billush, Poslisht, Zhur dhe besa edhe deri në Opojë. Mendoj që duhet të gjindet një lokacion më i përshtatshëm për këtë deponi. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Drejtori fjalën pastaj Dafina Alishani.

Çelë Lamaj (Drejtore e DSHP-së): Selman je hy në fushë të huaj, ne e dimë shumë mirë se çfarë është stadioni olimpiq, çfarë hapësirë e kërkon. Një stadion i cili sot është më funksional se sa ai projekti i prezantuar nga Ministria e Kulturës, nuk guxon asnjë stadion pa fushën ndihmëse. Nuk ka mundësi të zhvillohen përgatitjet në një fushë futbolli kur të luhet loja e kombëtares apo loja kryesore. Kështu që, ai investim është mirë, shumë mirë është me u bartë në lokacionin ku po kërkojmë ne që ta bëjmë shpronësimin e këtyre mbi 200 hektarëve. Këto janë rregullat e UEFA-s, nuk kanë me të pyet ty, por kanë me t'i kërkuar standartet, t'i ndërton stadion, po nëse s'i plotëson këto, atëherë ato mjete kanë shkuar kot. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Po Selman, një replikë të shkurtër.

Selman Sokoli (LVV): Shkurt, sa për temën zoti Lamaj, edhe dëgjo mirë, mëso diçka. Qeveria e Republikës e Kosovës dhe Federata janë marrë vesh që stadiumet e mëdha i ndërton qeveria për shkak se shumica që duhet me ndërtuar një stadium është shumë e madhe. Shtatë qendrat rajonale të Kosovës, tashmë i kanë projektet, i kanë mjetet për të ndërtuar stadione. Federata në bashkëpunim, memorandumet me komunat duhet të ndërtojë stadione të vogla lokale. Ato stadione mund të jenë për shembull edhe në Kabash të Hasit që i keni çuar disa bagera pa plane, pa projekte, veç po gryjnë aty, edhe në Gjonaj të Hasit që s'po ndërtohet, nuk ka zhveshtore të asaj. Kështu që, ju keni hyrë në fushë të huaj edhe këtë e bëni për hesape shumë të ulëta politike. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dafina Alishani fjalën.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit. Jam e mahnitur me vizionin tuaj zotëri Çelë Lamaj, sinqerisht. Domethënë doni me i impresionuar lojërat mesdhetare me e dërguar një stadium afër Deponisë! Sinqerisht vizion më të mirë se të juaj s'kam ndier. A bën me i lënë këto luftrat që i keni në nivel qëndror edhe me i pranuar ato investime sepse është një planifikim dhe është bë. Ne absolutisht nuk jemi kundër ose nuk jemi për lejimin e privatizimit të pronave, por kaq shpejt me ardhur një vendim, kaq shumë hektar tokë, pa u analizuar me u votuar, po më duket pak e jo e logjikshme! Nëse ka shumë vlera ose ka afate që duhet pak më shpejtë me reagu. Ne mundemi me bërë edhe seancë e jashtëzakonshme, por vijmë këtu duke e analizuar komplet listën, duke i analizuar pronat dhe pastaj të bindur që nuk po gabojmë, se nuk është hera e parë që të dilni këtu dhe na dezinformoni. Unë nuk dua me votuar diçka pa qenë e sigurtë, nuk dua me votuar diçka me fjalët e juaja, se s'është hera e parë që na dezinformoni. Kështu po më vjen keq, nuk keni lënë vend. Pa e analizuar këtë është edhe për të ardhur keq sepse në KPF ne nuk kishim shumë pika kryesuese. Apo është në ndonjë tendencë tjetër? Lëni lojërat mesdhetare, ka kush i mendon lojërat mesdhetare. Nëse nuk gaboj ose mirë është me na informu. MKRS-ja e ka pasur një takim me juve lidhur me lojërat mesdhetare. Çka është kërkuar prej juve? Ne nuk e kemi asnjë informatë

prej anës palës të juaj se çka është kërkuar si komunë!. Edhe sa jemi të gatshme me e bë atë. Jo tash në minutë të fundit me i bë këto planifikime edhe me iu mbivendosë lojërave olimpike stadium afër deponisë! Se di, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Dafina. Ju kisha lutur rreth kësaj pike në qoftëse hyn në rend dite, mandej mundemi me e diskutu. Kështu që diskutimet sa s'ka hyrë në rend dite, është propozimi, mandej mundemi, kemi të drejtë me votuar edhe për edhe kundër dhe kur vjen radha e diskutimit të kësaj pike mundemi me diskutuar më gjerësisht. Zotëri Muqa fjalën.

Agim Muqaj (AAK): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje ekzekutiv, kolegë të nderuar, qytetarë të nderuar. Ne si anëtarë të grupit të aleancës, sigurisht se do ta mbështesim këtë iniciativë dhe propozim. Sigurisht se jemi pro interesit të qytetarëve të komunës e Prizrenit dhe jo të privatizohet kjo pronë në çfarëdo destinacioni që do të shkon. Kështu që ne do ta mbështesim. Mirëpo kisha dashur të kyqem te pika tjetër, e mbështesim propozimin e Shukri Qunit për iniciativën që të hiqet ajo pikë nga rendi ditës edhe kisha dashur që në të ardhmen që kuvendi komunal së bashku me kryetarët e bashkësive lokale apo të lagjeve që të jenë pak më mirë të organizuar në takime dhe shqyrtimi i problemetve të jetë pak më, paraprakisht informatë e saktë që mos të merren vendime apo propozime të iniciativave të ndryshme sepse shpeshherë më ka rastis të ndodhë që nëpër lagje apo kryetarët e fshatrave që deri në fund të takimeve ku bëhen edhe dëgjimet publike, nuk janë të informuar për iniciativat. Kështu që, kisha dashur më mirë në të ardhmen të organizohen takimet me kryetar të bashkësive lokale dhe qytetarëve dhe të mirren vendime. Atëherë besoj që do ta mbrojmë interesin qytetarë më mirë ashtu siç duhet. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Muqaj. Atëherë patëm propozim që pika e tetë të largohet nga rendi i ditës, si nga zotëri Quni po ashtu e mbështetën edhe shumë anëtarë të kuvendit, po ashtu propozoi edhe drejtori Çelë Lamaj. Kështu që po e hedhim në votim. Kush është për që të largohet pika e tetë nga rendi i ditës? 33 jemi prezent. Unanimisht, ju falenderoj të gjithëve. Si dhe është bërë propozimi i ri gjithashtu nga drejtorit Çelë Lamaj, kush është për që ky propozim i ri të hyjë në rend ditë për sot? 33 jemi prezent. 25 për, 06 kundër, zero abstenim, atëherë dhe propozimi i ri hyn në rend dite. Tani po hedhi rendin e ditës në tërësi në votim. Kush është për që të miratohet në tërësi rendi i ditës? 33 jemi prezent. 31 për, zero kundër dhe zero abstenim, atëherë miratohet rendi i ditës për ditën e sotme. Ju falenderoj të gjithëve kalojmë te pika e tretë.

Pika e tretë;

pyetjet e kuvendorëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Agim Muqaj, Tajar Susuri.

Agim Muqaj (AAK): Përshëndetje edhe njëherë. Kjo pyetje është e dedikuar direkt për Drejtorinë e Shërbimeve Publike për Çelë Lamaj, pasi që kemi deri tash shumë kërkesa dhe vërejtje për kompaninë e cila mirëmban elektrifikimin në qytet dhe nëpër lagje të qytetit. Mendoj se është një vërejtje nga qytetarët, besoj që edhe ju keni marrë kërkesa drejtpërsëdrejtë nga qytetarë të ndryshëm. Mirëpo kompania besoj që nuk ka qenë e përgatitur për tenderin e cila e ka marrë pasi që problemi ne e dimë që Prizreni dhe gjithë Kosova ka mjaftë por nuk janë as serioz në kërkesat e qytetarëve e lagjeve apo rrugëve. Drejtpërsëdrejtë veç kam pasur dy-tre herë thirrje dhe nuk kanë reaguar me kohë, kështu që me muaj presin qytetarët, ka rrugë të caktuara që me muaj janë në pritje. Një shembull është në rrugën Malësi e Re, i tërë viti pasi që tash jemi në sezon dimnore, rruga prej magjistrales, rruga Ibrahim Rugova që shkon drejt fabrikës së çokollatës, domethënë është mbi 300 metër krejt në errësirë. Kam telefonuar edhe vetë, po, po, por asgjë s'ka. Kështu që kisha dashur që t'ia jepni si vërejtje të drejtpërdrejtë. Edhe rruga Dinë te Temaj është e njëjta gjë.

Kisha dashur, i nderuar drejtor që pak a shumë, të jepni vërejtje pak më serioze kompanisë që t'i merr seriozisht. Edhe tash sigurisht se sezona dimore dallon nga viti gjatë verës apo sezonës, shkojnë fëmijët në shkollë, vijnë në errësira, 200, 300 apo 500 metër, unë mendoj se është shumë edhe ta marrin pak më seriozisht ose ta marrin një vërejtje serioze nga vetë ju si drejtor, i cili e menaxhoni këtë kompani. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Muqaj. Fjalën e ka Tajar Susuri, përgatitet Bajram Kastrati.

Tajar Susuri (LVV): Faleminderit kryesuese, ju përsëritet të gjithëve. Unë kam disa shqetësime dhe disa kërkesa dhe ju drejtohem kryetarit. Shqetësimet e mia dhe banorëve të Zhurit dhe rrethinës janë këta. Deponia e inerteve të ngurta, vetë fjala po tregon që janë deponia e inerteve. Kjo deponi po shfrytëzohet edhe nga materiale të tjera dhe nga bërllogu i cili nuk ka të drejtë të gjuhet aty, por më e keqja është se aty po gjuhen edhe mbetjet shtazore. Kjo po e bënë situatën edhe më të keqe. Nga këto mbetjet e gjithë zona e Vrinës dhe e Lumës po bie aromë e pakëndshme, sidomos aty ku keqbërësit po e ndezin dhe ju si institucion nuk keni marrë masa. Tymi dhe flakët ishin prezent dy muaj! Kjo zënë mori një pamje dhe na kujtonte kohën e luftës. Kryetar, ne nuk jemi kundër deponisë, por jemi kundër hedhjes mbetjeve shtazore. Çfarë mundesh të bësh ti që t'i ndalosh dhe të mos vazhdohet kjo dukuri shqetësuese për banorët e Zhurit dhe rrethinës? Shqetësimi tjetër është për ujin e pijes. Zhuri po mbetet pa ujë, shpeshherë ose më mirë të them deri nga një një javë. Ne e dimë që ne kemi ujin me pompa dhe normal ka dhe defekte, domethënë janë të pranueshme. Por e papranueshme është që një defekt i madh apo sadoqoftë i vogël të merr kohë pak me orë ose me çështje ditore. E papranueshme është që të shkon java dhe banorët e Zhurit të mbesin pa ujë të pijes, ti je kryetar dhe duhet të bësh një zgjidhje të këtij fenomeni. Drejtorit të Kulturës, shkurt i kam një dy pyetje. Po shkon viti 2024, për vitin 2025, a do të lëshohet në funksion Shtëpia e Kulturës dhe stadiumi, apo qysh e keni gjetur qashtu keni me lënë? Ne në Zhur jemi bërë imun për punët që po mbeten gjithashtu të papërfunduara ose përgjysëm. Për Drejtorin e Shëndetësisë, kur do të pajisë QMF-në në Zhur me një ambulancë? sepse kjo është shumë me rëndësi për banorët e Zhurit. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Susuri. Fjalën e ka Bajram Kastrati, ju kisha lutur që ta respektoni kohën maksimum sepse ka shumë të tjerë që po presin me marrë fjalën. Po mandej Adrit Krasniqi.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, ekzekutiv, të nderuar kolegë, qytetar të Prizrenit. I nderuar drejtor Çel Lamaj, po ripërsëris një kërkesë, rruga Prizren-Gjakovë, konkretisht qasja e rrugës tek tranziti. E kemi kërkuar edhe më herët, keni thënë që nuk po bëhet rrethrotullimi! s'paku të bëhen semaforë ose dhe shenjëzimi i rrugës në atë formë përderisa qytetarët për kyqje në rrugë kryesore duhet t'i kalojnë tre korsi. Një pyetje tjetër, një kërkesë e kam që është e parashtruar edhe me shkrim prej banorëve të Lubizhës së Hasit. Është rruga Lubizhd-Kabash, është parashtruar edhe më herët me shkrim, ajo rrugë do asfaltim ose kubzim, që lidh dy fshatra dhe jo vetëm, lidh këto dy fshatra dhe të gjithë banorët e shfrytëzojnë atë pjesë. E kam edhe një vërejtje ose një pyetje për Drejtorin e Administratës gjatë vizitës që kemi bërë gjatë festës së nëntorit në varrezat e dëshmorëve. Pjesa te objekti i muzeut nuk është i mirëmbajtur si duhet. Veç ta dimë në kompetencën e kujt është edhe pse sidomos mirëmbajtja brenda muzeut, brenda objektit është e tmerrshme. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Kastrati, fjalën e ka Adrit Krasniqi përgatitet tek Egzona Hoxhaj.

Adrit Krasniqi (PDK): Faleminderit Kryesuese. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Financave ose për Nënkrytarin, ndoshta Nënkrytari ka me informu pak më mirë. Vjet ka qenë për herë të parë nëse s'gaboju mbështetja për nënat lehona e propozuar nga gratë kuvendare këtu. E për sivjet nuk kemi parë thirrje ende, po dua me ditë, po dua me u informuar sepse kam kërkesë nga qytetarët. Kur do të filloj si procedim, a do të ketë thirrje apo a do të ketë mbështetje për nënat lehona të vitit 2024? Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Adrit. Egzona Hoxhaj fjalën, përgatitet Shukri Quni.

Egzona Hoxhaj (PDK): Faleminderit kryesuese. I nderuar kryetar, i nderuar nënkryetar, të nderuar ekzekutiv, kolegë kuvendar, media e shoqëricivile, të nderuar qytetarë të komunës së Prizrenit. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Shëndetësisë në këtë rast. Drejtor njëjtë edhe pyetja ime lidhet pak a shumë për çështjen e subvencionimeve. A ka pasur thirrje ose a ka me pasur thirrje sa i përket subvencionimit për njerëz të prekur prej kancerit? Për shkak që kemi informacion që çdo herë është numër jashtëzakonisht i madh i këtyre njerëzve që janë të prekur me këtë sëmundje dhe kanë jashtëzakonisht nevojë që ta kenë një përkrahje prej institucioneve në këtë rast. Pyetje tjetër shkon për Drejtorinë e Administratës. Drejtor, ne kemi votuar këtu në kuvend komunal rregulloren kur i ka pas planifikime çmimet sa i përket shërbimeve që merren në Drejtorinë e Administratës, po edhe në drejtoritë të tjera sa i përket komunës së Prizrenit. Kam ankesa që nuk po gjen zbatim lirimi prej pagesave për personat me aftësi të kufizuara. Ata po kërkojnë prej zyrtarëve nëpër institucione që me u liruar prej këtyre pagesave, por nuk po e marrin këtë shërbim për shkak që po marrin një përgjigje që nuk janë të informuar në bazë të shkafit mujnë me u liruar. Kështu që tu kisha lutur që me ju drejtuar përfaqësuesve ose zyrtarëve që punojnë këto institucione edhe me i njoftuar që ne përmes rregulloreve e kemi shumë mirë të rregulluar në këtë çështje. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Hoxhaj. Fjalën e ka Shukri Quni, përgatitet Petrit Hoxhaj.

Shukri Quni (NISMA): Faleminderit Kryesuese. Përshëndetje edhe njëherë për të gjithë, përshëndetje kryetar. Kam një kërkesë Drejtor i Shërbimeve Publike, drejtor Çel Lamaj. Është një kërkesë prej banorëve të lagjes Jeta e Re, rruga që shkon për Nashec, është fjala rruga Besim Shala. Aty banorët kanë një breng të madhe, është fjala për një rrugë e cila kërkojnë të shtrohet diku 1000 metra. Rruga që vjen prej autostradës, domethënë nuk ka trotuar, nuk ka as ndriçim edhe nxënësit prej asaj lagje për me shkuar te shkolla Haziz Tolaj i duhen diku 3 km, saktë nuk e di sa është. Ata kërkojnë që një rrugë që e shkurton, prej rrugës Besim Shala e shkon te shkolla fillore e mesme-ulët Haziz Tolaj. Është shumë me rëndësi drejtor me u ushtruar ajo rrugë edhe megjithëse e njoh mirë atë pjesë, por edhe është kërkesë e banorëve aty. Mundesh me e çuinxhinierin apo punëtorin që e keni aty dhe e saktëson. Po ashtu edhe një rrugë në qytet disa banorë kanë kërkuar. Rruga Fahrudin Hoti thotë është e dëmtuar shumë edhe janë dëmtuar kubzat, po ashtu janë shfaqur edhe gropa, andaj kërkojmë që të rregullohet kjo rrugë. Edhe për ndriçim drejtor o fjala po flas për Nashec por edhe për fshatrat e tjera që kjo veç kaq gjë është zgjatur ndriçimi, mirë është me u rregulluar, se tash kemi edhe zgjedhje, më shumë ju vyjnë këta që janë kandidatë që kandidojnë. Drejtor, 70.000 euro që i ndamë për rezervarin për Nashec, është fjala për ujë të pijes, shkoi viti, ato mjete shkuan në suficit. Nuk jeni fajtor, ju kam falenderuar edhe kryetarin që më ka përkrah në këtë drejtim, edhe juve si drejtor që më keni përkrah, edhe kuvendarët këtu që e kanë votuar këtë kërkesë timën për me u ndërtuar ai rezervuar. Këtu këtë barrë e mban drejtori apo ushtruesi i drejtorit Fadil Berisha i Hidroregjionit Jugor i cili e ka refuzuar këtë kërkesë. Ai ka dhënë një propozim që do të ndërrohet një gyp i asbestit edhe atë gyp nuk e ka ndërruar, omethënë as kjo as ajo. Andaj, këto mjete po shkojnë në subficit. Ju kam thënë me disa herë e kam ngritur këtë çështje

edhe e kam ditur që ka me ardhë kjo, po jo me fajin e juaj, po me fajin e Hidroregjionit Jugor. Unë kisha propozuar që Hidroregjionit Jugor asnjë cent mos me ja nda hiç, nuk e meritojnë ata. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Quni. Fjalën e ka Petrit Hoxhaj, përgatitet Selman Sokolaj.

Petrit Hoxhaj (GUXO): Edhe njëherë përshëndetje e nderuara Kryesuese, i nderuar kryetar, nënkryetar, koleg kuvendarë. I nderuar Drejtor i Shërbimeve Publike, kemi një shqetësim dhe një kërkesë prej branorëve të fshatit Petrovë. Është një rrugë që është çelur nga TA-ja dhe që del në fshatin Petrovë, është hapur ajo rrugë, mirëpo është tash ka filluar të bëhet edhe deponi e mbeturinave. Përpos mbeturinave të ngurta kanë filluar t'i hudhin edhe kafshët e ngordhura! është mirë që të parandalohet dhe të mos të krijohet deponi më e madhe ilegale. Ndërsa e nderuara Kryesuese, flas në emër të Kryetarit të Komisionit për Bujqësi dhe Turizëm, kemi kërkuar në mënyrë zyrtare prej dy drejtorive disa informata në mënyrë që të bëjmë raportin vjetor. Mirëpo asnjë prej këtyre drejtorive nuk ka qenë e gatshme që të na japë informata! Për dallim prej Drejtorisë së Bujqësisë që nuk është përgjigjur, është shqetësuese hala më keq Drejtoria e Turizmit. e-mailin zyrtar tonin kërkon që ne ta dërgojmë në mënyrë fizike dhe të protokolluar sepse do të thotë nuk është legjitime thotë ky komision. Dhe jemi detyruar që qat e-mail zyrtar e kemi protokolluar dhe e kemi dërguar dhe tash bëhen dy muaj që nuk kemi kurrëfarë përgjigje. Mosrespektimi i këtij komisioni është drejtpërdrejtë mosrespektim i kuvendit sepse kuvendi e ka formuar këtë komision. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Hoxhaj. Fjalën e ka Selman Sokolaj përgatitet Sevil Kazazi.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit e Kryesuese. Besoj pjesën e parë nuk ma numëroni kohën për shkak se e kam një çështje që ka të bëjë me fjalën e kuvendarit juaj ose Shefit të Kuvendarëve të PDK-së. Zonja Kryesuese, ne e kemi pasur bashkë një diskutim. Ne e kemi një rregullore për subvencione, e kemi amendamentuar atë rregullore edhe sinqerisht po habitna me nivelin e njohurive që i keni ju për punët ose përshkrimin e punëve që e keni. Për shkak se edhe për sëmundje të rënda me kancer, edhe për fëmijët nënat lehora, ekziston një procedurë e qartë edhe një shumë e qartë minimale, edhe një periudhë kohore që fatkeqësisht ne jemi munduar si Vetëvendosje disa herë t'i sensibilizojmë qytetarët, nuk e di a kanë aplikuar. Mirëpo është një periudhë tre mujore, nëse fëmija i bën tre muaj, nëse dikush gjatë këtij viti ka lindur edhe i ka fëmijët tre muaj, fatkeqësisht në bazë të rregullores e për fajin tuaj nuk mundet me aplikuar. Mirëpo nëse doni me shkuar me paralelizma nuk e njihni rregullore që punoni, atëherë është çështje e juaj. Sa i përket pyetjeve ose çështjeve që kam me i ngritur, Kryetari i Komunës së Prizrenit Shaqir Totaj, i cili është i ulur aty përballë vazhdimisht në çdo intervistë më shumë merret me çështje nacionale, më shumë merret me Qeverinë e Kosovës se me punët e tij! Njëra prej deklaratave të famshme të tij është mos bashkëpunimi, mos hapja e telefonave. Unë i kam disa e-mail këtu të zyrtarëve qeveritarë që ja kanë dërguar Shaqir Totaj, disa thirrje telefonike që ky nuk i ka përgjigjur dhe stafi i tij. Thirrja e fundit ose e-mail i fundit ka qenë në takimin e Ministres Rozeta Hajdari me prodhuesit e Prizrenit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Selman a ke diçka çështje në lidhje me komunën e Prizrenit, apo me axhendën e kryetarit?

Selman Sokolaj (LVV): çështje ka të bëjë, çështje është.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po çfar çështje, kush ka dhënë intervistë, çka ka thënë në intervistë, të lutem.

Selman Sokolaj (LVV): Për zonë ekonomike, a ban mos me më ndërpre.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jo veç me axhendën e kryetarit s'ke nevojë.

Selman Sokolaj (LVV): s'ke nevojë me um ndërpre se për zonën ekonomike a po kupton? Apo e ke mendët dikah tjetër? Jemi tuj folë për zonën ekonomike edhe Shaqir Totaj ka qenë i ftuar,

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Pak ma i kujdesshëm duhet me qenë, a kuptojmë a s'kuptojmë se vlerëson ti.

Selman Sokolaj (LVV): Shaqir Totaj, kryetar i komunës e Prizrenit ka qenë i ftuar edhe nuk ka marrë pjesë. Mirëpo ajo qa ke interesant që bizneset nuk e dishin që kanë qenë të ftuar. Ramadan Tarashaj, e kanë thirrë prezent me load speaker njerëzit, nuk e ka ditur që ka qenë e ftuar komuna e Prizrenit edhe po thirrën që s'kanë qenë të ftuar. Kështu që ka qenë i ftuar, veç duhet me bashkëpunuar. E dyta, ka të bëjmë me projektin e banimit të përballueshëm dhe banimit social. Është hera e dytë që po kryehen aplikimet, pothuajse nuk ka mbetur komunë në Republikën e Kosovës e udhëhequr nga cilido subjekt që nuk ka aplikuar. E vetmja komunë që s'ka aplikuar në atë projekt ose i vetmi kryetar që s'ka aplikuar në atë projekt është Shaqir Totaj! Me të vërtetë është e dyshimt sjellja e këtij njeriu edhe si ky ja do të mirën këtij...

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Selman, tre minuta veç të kaluan, tu kisha lutur që çështjet që të kanë mbetur në mbledhjen tjetër. Tre minuta a ju kaluan? Unë kërkoja me respektu kohën, ti po merresh sa po kuptoj unë, sa s'po kuptoj unë. Po merresh me agjendën e kryetarit.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese, a je e sigurtë veç qe çdo pasfolës i imi nuk ka me shkuar më shumë se tre minuta. A më garanton?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): N'varet, për çështjet konstruktive po më vjen shumë keq me ja ndërpre kolegëve kuvendarë.

Selman Sokolaj (LVV): Jam shumë afër me e përfunduar Kryesuese. Për Drejtorin e Shërbimeve Publike, sa i përket kësaj ju kisha lutur edhe njëherë Shaqir Totaj edhe juve, është projekt shumë me rëndësi për qytetarët e Prizrenit, për familjet skamnore, për qytetarët që kanë nevojë me iu rindërtuar shtëpitë, për zyrtarët publik që mund të përfitojnë banesa të përballueshme, për familjet në asistencë sociale që mund të përfitojnë banesa. Domethënë, ky është projekt pikërisht në interes të qytetarëve dhe në interes të qytetarëve të Prizrenit. Veç është një inati, një person inatxhi me një diplomë të Obamës që nuk mundet me aplikuar.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit për fjalën. Sevil Kazazi fjalën e ka, përgatet Alban Bislimaj.

Sevil Kazazi (YTHP): 40.10- 42.15 min (Pjesa 1) hepinizi saygıyla selamlıyorum. Sorularımı geçmeden önce 9 şubat 2025 tarihinde Kosova Parlamentosu'nda Prizren Belediye Meclisi'nden milletvekili adayı olarak katılmış olan bütün adaylara tebrik etmek istiyorum. Başarılar dilemek istiyorum. Bu seçimlerin Kosova için ülkemiz için ve tüm Kosova soydaşlarımız için hayırlı uğurlu olmasını temenni ediyorum. Yönetim Müdürlüğüne bir sorum olacak. 3 yıllık idareniz içerisinde Prizren Belediyesi bünyesine Türk toplumuna mensup kaç vatandaşımız istihdam edilmiştir? Bunu

öğrenmek istiyorum. Diğer taraftan müfettişlik müdürlüğüne bir sorum olacak. Şehirdeki kahve ve restoran işletmeleri içinde sigara içilmesi konusunda herhangi bir denetiminiz var mıdır? Gözlemlediğim kadarıyla kapalı alanlarda sigara içiliyor maalesef. Son oraq kamu hizmetleri müdürlüğüne bir sorum və bir talebim olacaq. Geçen oturumu da tabakhane ki su sorunu dile getirmişdim. Bir baxtım ki bu sefer Remzi Ademay ki Şadırvan Bölgesi'ne ait bir alan. Bu cadde üzerinde sular kesilmeye başladı. Bu sorunun nedenini ve ne zamana kadar devam edeceğini size sormak istiyorum. Ayrıca şehir hatları otobüs seferlerinin de artırılması, özellikle okul saatlerine göre düzenlenmesi öğrencilere, emeklilere ve engelli vatandaşlarımıza.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faliminderit shumë zonja Kazazi. Fjalën e ka Alban Bislímaj, përgatitet Islam Thaqi.

Alban Bislímaj (PDK): Faliminderit Kryesuese. Përsëndetje për kryetarin, kolegë kuvendar, ekzekutivin, mediat, qytetarë. Unë i kam dy kërkesa në lidhje me shërbimet publike. E para është në lidhje me sinjalizimin. Ne po shohim që çdo ditë është kah punohet te sinjalizimi horizontal dhe vertikal. Tash është koha kur ka një ndërprerje të sinjalizimit horizontal për shkak të kohës së dimrit. Por e shoh çdo ditë që te sinjalizimi vertikal është duke u vendosur shtylla në të gjitha rrugët e qytetit. Por unë e kam një kërkesë konkretisht te rrethrotullimi i tranzitit të ri te TA-ja. Kam biseduar dhe me të kompanisë që aty diçka ja kanë huqur të rrethrotullimi për shkak që kanë qenë disa sinjalizime ekzistuese të mëhershme, të cilat kanë qenë për momentin derisa rruga ishte e bllokuar te tranziti i ri, por ata kanë vendosur disa sinjalizime të njëjtat qysh kanë qenë edhe më herët! Është fjala për kthim i obligueshëm të djathtë, sinjalizim horizontal, tash nuk ka nevojë të jetë një kthim i obligueshëm djathtas, sepse të gjitha rrethrotullimet që janë në atë rrugë janë mirë, përveç atij rrethrotullimi. Edhe është diametri i vijave të bardha, të cilat nuk e kanë diametrin e duhur siç është e parapërme me rregulla, aty të bëjnë një intervenim në përmirësim. Kam biseduar dhe me ta, po, nuk po e shoh ndryshimin, u bënë disa ditë e javë që nuk po nuk po e shoh. Është mirë të ndryshohen ata sinjalizimet horizontale, ose të hiqen fare më mirë të vazhdohet me rregullat të rreth rotullimeve. E dyta, ka të bëjë me ndriçimin publik edhe këtu po shihet që është duke bërë një punë e mirë çdo ditë në qytet edhe fshatra. Por unë kam një kërkesë në lidhje me ndriçimin publik në fshatin Kobaj. Aty domethënë ekziston një ndriçim publik por kam kërkuar edhe më herët, kam pasur kërkesë edhe me shkrim, të cilat janë të shkundne, janë defekt, edhe unë kisha dashur bile rruga kryesore që ata në defekt që janë të aktivizohen dhe të rregullohen dhe kur t'i vjen radha, patjetër që do të bëhet edhe rrjeti i sinjalizimit, domethënë ndriqimit të ri. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Bislímaj. Fjalën e ka Islam Thaqi, përgatitet Naxhije Memaj.

Islam Thaqi (LVV): Faleminderit Kryesuese. Përsëndetje për ekzekutivin, kryetarin, kryesuesen dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Pyetja e parë është kërkesë e parashtruar nga një pjesë e banorëve të rrugës Salajdin Xhezairi. Drejtor Çelë Lamaj, ata thajse gati një vit kanë probleme me ndriqimin publik, do të thotë bëhet fjalë për 200 metat e fundit të rrugës Saladin Xhezairi. Aty është ndërhy gjatë mandatit tuaj dy-tri herë domethënë në rregullimin, mirëpo pjesa e fundit e rrugës thajse që një kohë të gjatë nuk ka ndriçim fare publik. Është edhe një kërkesë me shkrim e parashtruar te ju në drejtori. Pyetje e dytë është një kërkesë për ta them dy drejtori apothujse edhe për policinë e Kosovës që të bëhet një aksion i përbashkët, nga Drejtoria e Inspektorateve, Drejtoria e Shërbimeve Publike edhe policia e Kosovës e pikërisht ka të bëjë me uzurpimin e hapësirave publike, ku bëhet fjala për hapësira për parking. Shumë qytetarë të lagjes Ortakoll, Lakuriq, bëhet fjalë për pjesët urbane të qytetit, kanë ankesa për veturat që janë të palëvizshme thajse, ka në disa vende që rrinë me vite, do të më kanë dërguar dhe fotografi. Do të keni rastin,

mos t'i përmendi rrugët, por në Ortakoll është e theksuar, Lakuriç është e theksuar, madje është e theksuar edhe në parkingun këtu mbrapa Shtëpisë së Bardhë që është parking publik. Do të thotë shumë qytetarë e kanë ngritur si shqetësim që këto vetura të largohen dhunshëm nga Drejtoria e Inspektorateve, por në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, se ka prej tyre që edhe nuk janë të regjistruara fare. Edhe këtë vit si çdo fundvit do të thotë po e ripërsëris një kërkesë e që të ka të bëjë me fushën e subvencionimit kryetar. Edhe vitin paraprak kam kërkuar që të shikohen mundësitë ashtu siç e bëjnë disa komuna të tjera që të subvencionohen punëtorët të gjithë punëtorët e administratës. Si shembull komuna e Prishtinës që bënë në fundvit, në pamundësi ligjore për t'i shpërbly punëtorët me pagën e 13, shkon me subvencionimin e një vlere të caktuar ku punëtorët e administratës pastaj i përfitojnë këto benefite duke u furnizuar me pako ushqimore e të ngjashme. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Zotëri Thaqi, ju faleminderit. Zonja Naxhije Memaj fjalën e ka, përgatitet Ilir Gashi.

Naxhije Memaj (LDK): Përsëritet kryesuese, përsëritet për të gjithë të pranishmit në sallë. Për Drejtoreshën e Arsimit. Drejtoreshë, a jeni në dijeni se nxënësit e shkollës së mjekësisë, konkretisht viti i parë mjekësia e përgjithshme, nuk po ju vijnë disa profesorë. Fëmijët jo vetëm se nuk zëvendësohen nga profesorë të tjerë, por ata i qesin jashtë për orë të tëra në këto ditë të ftohta dimri! Nga dy javë i mungojnë disa profesorë të lëndëve profesionale. Ata dalin jashtë vendit, tash me leje apo jo nuk dihet, por kryesore fëmijët nuk mbajnë mësim. Kështu që, ndjej shqetësimet e prindërve sepse nxënësve ju krijohet hapësirë të sorollaten rrugëve e aq më keq edhe të konfliktohen nxënësit në oborr të shkollës. Pra drejtoreshë, kërkoj nga ju që të merrni masa në këtë drejtim në mënyrë që fëmijët të zhvillojnë mësimet në mënyrë të rregullt. E dua të ngris edhe një çështje përsëri, e çështjen e rreth rrotullimit në lagjen Bajram Curi në Prizren. I nderuar drejtor dhe i nderuar kryetar, kërkoj dhe insistoj që sa më parë të ndërmerrni hapa konkret që në lagjen Bajram Curi të ndërtohet një rrethrotullim sepse ku e keni çuar rrethin ju atje poshtë afër 3 km larg nga lagja veçse jeni duke i maltratu banorët e kësaj lagje. Unë vetëm një fjalë kam për ju, mos harroni se afër janë zgjedhjet lokale. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Naxhije Memaj. Fjalën e ka Ilir Gashi, përgatitet Ertan Simitçiu.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zonja kryesuese. Përsëritet për kryetarin, ekzekutivin dhe të gjithë të pranishmit. Kërkesa e parë i drejtohet Kryetarit të Komunës. Kryetar, tash po afrohen festat e fundvitit dhe e dimë telashin çdo vjet që e kemi me fishekzjarret. A ekziston mundësia që edhe komuna e Prizrenit si komunat tjera ta nxjerrë një vendim për ndalimin e përdorimit të fishekzjarreve në hapësirat publike për ta ruajtur sigurinë, qetësinë dhe shëndetin e banorëve të komunës së saj. Çështja e dytë ka të bëjë me Drejtorinë e Arsimit. Zonja drejtoreshë a keni informata në lidhje me nxënësit që janë lënduar duke luajtur lojërat e rrezikshme të nxitura nga rrjetet sociale? Unë e kam një rast konkret në Ortakoll, në shkollën Ortakoll që ka ndodhur. A keni ndonjë raport se çfarë po ndodhë? Sa lëndime janë përjetuar deri më tani dhe çfarë është ndërmarrë në këtë drejtim nga ana e drejtorisë që e udhëhiqni ju? Pika tjetër ka të bëjë me pengesat e betonit në rrugën Shuaip Spahiu. Propozoj që këto pengesa të largohen sepse e shëmtojnë pamjen e kësaj rruge dhe pengojnë lëvizjen e lirë. E kuptoj hallin për të parandaluar parkimin ilegal, por besoj që ka mënyra të tjera duke filluar nga bashkëpunimi më i ngushtë me Policinë e Kosovës me vendosjen e tabelave për ndalim parkimi, kamerave të vëzhgimit deri në angazhimin e sigurimit fizik privat që do të kujdesej që aty mos të parkohej dikush. Për Drejtorinë e Kulturës. Drejtor, përse në listën e laureatëve të vitit 2024 në fushën e sportit nuk është paraparë edhe shpërblyimi për notuesit apo për notarët apo notaren e vitit? Klubi i Notit në Prizren është një klub jashtëzakonisht shumë i

suksesshëm që ka fituar disa herë medalje në garat kombëtare dhe ndërkombëtare. Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ilir tu kisha lutë pak sa më shkurt, veçse kanë kaluar dy minuta. Të lutem për mirëkuptim.

Ilir Gashi (LVV): Po në fund jam. Në rrugën Behamir Memaj, lagjja Jeta e Re, është rrugë e pa shtruar as me kubza as me asfalt. A mund të ndërmerret diçka që të rregullohet kjo rrugë? Ka ankesa nga banorët e lagjes. Gropat në rrugë, disa kërkesa personalisht i kam bërë, në Ortakoll, Bekim Berisha, në lagjen Kurilla, Istriotët. Qe disa muaj apo gati një vjet po bëhet, nuk janë mbyllur. Arsyeja pse nuk po bëhen? janë të protokoluara dhe të dorëzuara. Edhe një një vërejtje, duke filluar nga kryetari për të gjithë ekzekutivin. Pse po lejohen projektet me çmime marramendëse sikurse që dolën shtyllat elektrike 32.000 euro, shtyllat ndriçuese 2.700 euro, parking për bicikleta 1200 euro....

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ilir, të kanë kaluar tre minuta, të kisha lutur, të kisha lutur.

Ilir Gashi (LVV): Kryesuese po flasim për çështjet e përgjithshme.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): po veç sipas rregullores në dispozicion i keni veç 2 minuta. Të lutem përmbyle.

Ilir Gashi (LVV): Të kemi kujdes, është para publike. Kalon buxheti nga kuvendi, menaxhohet nga ekzekutivi, të arsyetohen pse një parking 1200 euro kur është disa fije të hekurit që kushtojnë jashtëzakonisht shumë lirë. Pse kaq shumë me paratë tona po paguan këto shërbime? që kishin mujt me dalë shumë më lirë. Faleminderit për dëgjimin.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Ilir. Fjalën e ka Ertan Simitçi.

Ertan Simitçi (YTHP): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje të gjithëve. Herkezen Merhaba. Kam një kërkesë nga Drejtori i Urbanizmit po është edhe nga kryetari. Në këtë mandat ne kemi pasur një projekt-propozim, projekt ideal lidhur me ndërtimin e ashensorëve për banesat e vjetra. Po mendoj që është faza tash të fillojmë të diskutojmë këtë çështje drejtor, edhe nëse është mundësia të mbajmë një tubim publik me qytetarët, me përfaqësues të banesave që të shohim në cilat banesa kanë me pasur kërkesa për këto projekte për arsye se ka shumë ankesa nga qytetarët të cilat edhe janë të moshës të madhe, janë ndoshta edhe kanë probleme me shëndet, domethënë për lëvizje për shkak të çështjeve shëndetësore. Po kërkoj që në muajin shkurt të mbahet një tubim publik këtu në sallë, të ftohen të gjitha përfaqësuesit të banesave edhe ta diskutojmë këtë çështje që para kornizës afatmeshme buxhetore për vitet e ardhshme të bëhet një fizibilitet të projektit edhe të futet në kornizën për vitet e ardhshme. Mendoj që është për interes për të gjithë qytetarët, edhe është një projekt që besoj që edhe komuna e Prizrenit do ta ketë domethënë si një do të ketë një mbështetje për këtë. Poashtu edhe po mendoj që edhe mund të gjejmë edhe donacione të ndryshme nga institucione ndërkombëtare pasi që është një projekt social. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Ertan. Shukrije Berisha fjalën.

Shukrije Berisha (NISMA): Faliminderit kryesuese. Përshëndetje kryetarit Totaj, ekzekutiv, koleg kuvendarë dhe ju të gjithë të pranishëm. Një kërkesë drejtuar Drejtoreshës së Arsimit. Drejtoreshë, a do të jepet dekoratat apo çmimet për vitin 2024? Ne si nisma kishim propozuar që çmimin Xhevat Berisha t'i ndahet mësimdhënësit me performancë më të mirë dhe të komunës së

Prizrenit, poashtu të vazhdohet edhe me çmime të tjera. A do të ketë mundësi këtë vit apo do të fillon me vitin tjetër? Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Berisha. A ka anëtarë të tjerë të cilët e dëshirojnë fjalën? Po urdhëro Ymrane Fusha.

Ymrane Fusha (PDK): Kërkesa është për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Drejtor është krijuar në një deponim mbeturinash midis qytetit të Bem-afi, rruga Skënder Rexhepi ose De Rada. Ndriçimi publik mungon te rruga Tahir Meha dhe rruga Tirana. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Fusha. Anëtarë të tjerë? Po urdhëro Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesuese. Ju përshëndes të gjithëve. Pyetjen e parë e kam lidhur me hapësirën afër ish-zyrave të PDK-së. A jeni të informuar që është rrethuar ajo pjesë edhe a keni informata se çfarë po bëhet aty? Sipas anëtarëve të cilët e kanë bërë atë, apo qytetarëve thonë që kemi leje nga komuna. Me çfarë leje është dhënë ajo pronë kur ne nuk. as nuk është dhënë në shfrytëzim ose as nuk është shpallur në ndonjë listë. A mundeni bashkë me Drejtorinë e Inspektoriatit me e pa se çka është duke ndodhë aty? sa i përket subvencioneve në DKRS, unë po dua me ju falenderuar më së pari që na keni ftuar me një darkë të fundvitit. Do t'ju rekomandoja që ato para që i harxoni me neve, më mirë i paguani subvencionet se janë në hall OJQ-të edhe klubet sportive. Mos bëni ner me paratë publike, po bëni ato detyra që i keni sepse vërtet ka disa OJQ që janë bllokuar për shkak të vonësës të pagesave e kjo vënesë do të duhej që dikush ta merr përgjegjësinë edhe të jep llogari, po edhe kryetari do të duhej t'i thirrë në përgjegjësi drejtoritë që nuk kanë ditë as me i shpenzuar buxhetin e tyre, as me menaxhuar si duhet. Nuk e kanë obligim paaftësinë e juaj OJQ-të me pagu kështu edhe mos me pasur mundësi me i bë as aktivitetet edhe as pagesat që i kanë bërë. Me dijeninë time janë disa OJQ që me paratë vetanake i kanë bërë aktivitetet dhe presin ende pagesa. Së paku dilni informoni që këtë vit nuk marrin pagesa, ato OJQ edhe klubet sportive. Po ashtu e kam edhe një shqetësim për Drejtorin e Inspektoriateve lidhur me një shtëpi shumë të vjetër e cila është në rrezik të shembjes te rruga Afrim Zhitija, rruga mbas Vektor Tursit. Me sa e di aty qytetarët na kanë informuar që ka qenë një kontroll prej inspektoriatit, po nuk e di a është inspektoriat komunal apo i nivelit qendror. Është në rrezik të shembjes, pa ndodh fatkeqësia aty ju kisha lut, në fakt edhe Drejtoria e Emergjencave është këtu e inkorporuar, ju kisha lut me u marrë me këtë shtëpi që mos të ndodhë më e keqja e pastaj të kemi probleme të tjera. Sa i përket pyetjes të parafolësve të mi lidhur me banderat, e ndriçimin, goxha smart ndriçime na keni pru, po nuk nuk po mujme e kuptu, çfarë çmimi mund të ketë një shtyllë 30.000 euro! çka po bën ajo? 32.000 euro, po ki fytyrë edhe me tregu që është më shumë! Oke, shumë mirë! Kjo është niveli i juaj qysh keni arritur me e zhvatë këtë buxhet të të qytetarëve.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të lutem, a mundesh me e përfundu se kaluan tre minuta.

Dafina Alishani (LVV): se keni problem me bërtit me zë të lartë me thënë 32.000 euro! Janë disa ulse 1. 700 euro! Ju për 900 euro s'na keni lënë këtu pa thënë kurgjo, tash po bëjka 1700 euro me bë ulëse. Pyetja e fundit, kryetar. Pasi je edhe i Hasit, duhesh me ditë që drejtori yt në stadiumin në Kabash të Hasit po punon pa leje. Këtë informatë e kam të konfirmuar nga Drejtoria e Urbanizmit. Do të duhej të kesh senzitivitet nën një, për investimet që kanë të bëjnë me sporte se je goxha një farë sportisti i shquar. Për Hasin që po veprojnë pa leje e sot ju dilni na tregoni se po bëheni gati për lojëra mesdhetare, ku po doni me i bë ato investime pa kurrfarë projekti? Aty po punoni me ujë, me rrymë, me të gjitha edhe kush e jep përgjegjësinë punimeve pa leje?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Dafina, të lutem se katër minuta gati o bënë. Në qoftë se nuk ka prej anëtarëve të kuvendit po zotëri Krasniqi fjalën.

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Edhe unë desha të kyq. Drejtohem te drejtori i DKR-së. Drejtor para disa muajve keni bërë një inaugurim të objektit të sallës aty në lokalitetin tim. Mirëpo në ndërkohë janë paraqitur disa defekte dhe ato defekte nuk po mundësojnë që të zhvillohen aktivitetet si të komunitetit po edhe të nxënësive të asaj shkolle. Kisha kërkuar nga ti që të merreni me punë kryesin pak më seriozisht që kjo punë të kryhet dhe objekti të jetë në funksion. Për Drejtorin e Bujqësisë. Drejtor para pak dite keni bërë ndarjen e subvencioneve të mjeteve bujqësore. Kam dëgjuar prej fermerëve që pjesa e dërmuese janë të kënaqur me punën që keni bërë, aty këtu ka pakënaqësi por ato janë normale. Po kërkoj nga ju që me rastin e fatkeqësive të erave të forta që kanë ndodhur para një muaj e gjysmë kështu, shumë serrat në atë pjesë prej nga vij unë dhe ti janë dëmtuar, keni marrë masa rreth asaj, a do t'i subvenciononi fermerët për ato dëme që janë bërë? Këto ishin të gjitha. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Krasniqi. A ka dikush tjetër? Në qoftëse jo atëherë po kalojmë te pjesa e ekzekutivit. Fillimisht kryetari fjalën e ka.

Shaqir Totaj (Kryetar i Komunës): Me qenë se është seanca e fundit për këtë vit sipas të gjitha gjasave, më së pari po dua me ju përshëndetur të gjithëve edhe me ju falenderu për kontributin që e keni dhënë gjatë këtij viti sepse konsideroj që kjo asambleja ka funksionuar relativisht mirë edhe këto janë vlera të demokracisë ku secili e thotë kryesisht në mënyrë të argumentume atë që e mendon. Po ashtu, meqënëse jemi në fund të vitit po dua me ju uruar të gjithëve festat e fundvitit edhe meqënëse këtu kemi kandidat për deputet nga disa parti, të gjithëve pa dallim partie po du me ju dëshiruar sukses në garë, sepse Prizreni si qytet sa më shumë të ketë deputet do të jemi me gjasë aq më kompetitiv në garën për tërheqjen e fondeve, projekteve e kështu me radhë. Disa më kanë drejtuar me pyetje direkte për çështjen e deponisë në Zhur, besoj që Çela është më kompetent me ju përgjigj. Për ujin, mendoj që ujin ja paguan Hidroregjionit, nuk ja paguan komunës, për këtë arsye drejtoju Hidroregjionit dhe jo komunës sepse ata janë kompetent për çështje të ujit. Përsa i për përket subvencionimit të punëtorëve, qysh që e ka bërë Prishtina, si ide është e mirë, po kam dilema rreth ligjshmërisë. Nuk jam shumë i sigurtë ligjërisht a kemi drejtë me e bërë një gjë të tillë apo jo. Edhe pjesa tjetër është se komuna e Prishtinës zakonisht ka një suficit shumë më të madhe se ne që e kemi edhe kanë mundësi me bërë një gjë të tillë. Por si ide e kemi diskutuar, por për shkak të dilemave rreth ligjshmërisë jemi tërhequr prej asaj ideje. Përsa i për përket fishekzjarreve, dje e kemi pasur takimin në Këshillin Komunal për Siguri edhe bashkë me policinë e kemi diskutuar këtë çështje edhe sipas t137 gjitha gjasave policia do të jetë në nivel të detyrës bashkë me inspeksionet e komunës për me i adresuar këto punë. Dikush na e përmendi edhe po vijnë zgjedhjet lokale, po dua me falenderuar se pasna pas harruar që kemi zgjedhje lokale vitin e ardhshëm. Kështu që faleminderit që na përkujtove. Përsa i përket parave publike te dikush ekziston ajo bindja që paraja publike janë paret tona. Nja 20 vjet kam punuar drejtor i ATK-së edhe e di sa vështirë është me i mbledhur ato para publike. Edhe kjo automatikisht e bën ngritjen e nivelit të kujdesit në shpenzimin e tyre edhe pse kurkush nuk është perfekt. Kur dikush thotë që janë parat tona, unë ju siguroj që nuk janë parat e juve, janë parat e buxhetit të komunës së Prizrenit e qat buxhet e menaxhon ekzekutivi me ndihmën e legjislativit. Secili qytetar i paguan obligimet e veta ligjore në formë të tatimit, por në momentin kur i paguan nuk janë më parat e veta, janë të buxhetit të qytetit. Për ashensor e përmendi Ertani, si ide është shumë e mirë, por është çështja e mundësive buxhetore, domethënë komuna sa do të ketë mundësi me financu një projekt të tillë për shkak se është relativisht i kushtueshëm. E krejt në fund disa deputetë ja u lejon niveli i komunikimit të tyre me e kontestuar fytyrën tonë, tha keni fytyrë, s'keni fytyrë. Atyre dy herë ja uroj vitin e ri edhe ju dëshiroj argëtim të këndshëm për festat e fundvitit. Ju falenderoj.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit kryetar. Dejtoresha e Arsimit fjalën e ka.

Luljeta Veselaj Gutaj (Drejtoreshë e DKA-së): Faleminderit Kryesuese. I nderuar kryetar, të nderuar kuvendarë, media, qytetarë të Prizrenit. Kam tre pyetje. Zonja Memaj, sapo mora informacion nga shkolla e mjekësisë, të gjitha orët të cilat kanë humbur për shkak të zhvillimit të profesional të mësimdhënësve, në këtë rast mjekët janë zëvendësuar dhe nuk është duke humbur asnjënjë orë. Tani edhe nxënësit të cilët kanë pasur ngatërresa është rehabilituar ajo situatë, kanë qenë shtyrje mes nxënësve, janë kthyer kamerat sipas drejtorit dhe janë marrë marrë masat dhe vërejtjet për nxënësit të cilët kanë shkaktuar këto pengesa. Zotëri Ilir, sa i përket lëndimeve dhe lojërave të cilat e kanë marrë hovin në gjithë Kosovën, jo vetëm në Prizren, sapo kemi kam parë këto lojra në rrjetet sociale, unë kam ndërmarrë masa dhe kam lëshuar një e-mail, kam kërkuar nga shkollat që të jenë të kujdesshëm, të bashkëbëjnë me prindërit, të punojnë me ekipet profesionale brenda shkollave që mos të kemi ndonjë rast me ndonjë fatkeqësi. Nuk kam raport zyrtar që ka ndodhur në ndonjë shkollë ndonjë rast i lëndimit. Përkundrazi kam raport nga policia e Kosovës të cilët kanë marrë masa dhe kanë dalë në terren në të gjitha shkollat, që në shkollat e Prizrenit nuk ka pasur ndonjë rast ose ndonjë nxënës që është lënduar. Dhe pyetje ose më shumë propozimi i zonjës Berisha, a do të jepen çmimet për mësimdhënësit më të mirë të vitit, me performancë më të mirë? Sigurisht si çdo vit, do të jipet edhe këtë vit çmimi, çmimet jipen me 7 mars për nder të ditës së mësuesit dhe kalojnë në bazë kritereve pas janarit të cilat përcaktohen me ligjet dhe udhëzimet që janë në fuqi dhe kriteret na vijnë nga Ministria e Arsimit, ne i zbatojmë dhe i shpërndajmë në shkolla. Gjithsesi do të jipet. Faleminderit. Mësimdhënësi ma i mirë i vitit e merr çmimin Xhevat Berisha sipas rregullores për dekorata. Është hera e parë që e kemi këtë rregullore dhe sigurisht që mësimdhënësi më i mirë do ta merr këtë çmim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Drejtori i Shërbimeve Publike fjalën.

Çelë Lamaj (Drejtor i DSHP-së): Pyetjes së kuvendarit Agim Muçaj rreth ndriçimit. Ne vetëm për qartësinë e juaj dhe të opinionit me këtë kontratën që komuna e Prizrenit e ka mund të mbulohet vetëm diku afër 25% e nevojave dhe kërkesave të komunës e Prizrenit. Qëllimi jonë është që qyteti të mbulohet me ndriçim. Kurse nëpër fshatra për gjithë përveç atyre fshatrave që kanë vetëm me projektin e një infrastrukturë e tjerë të përfshijmë edhe ndriçimin, të bëhet me ndriçim rrugët kryesore edhe rrugët deri te institucionet në këtë rast shkollat, xhamitë apo një institucion tjetër ambulanca si është. Kemi probleme, nevojat janë të mëdha. Prizrenit i duhen diku në bazë e një auditimi i cili na është bërë për mbi 25.000 trupa ndriçues, kurse ne i kemi diku afër me këtë kontratë kur të përfundohet që është kontratë tre vjeçare, kemi afër 6.000, domethënë është më pak se 25% i nevojave. Sa i përket pyetjes së kuvendarit Tajar Susuri, rreth deponisë së Zhurit? Ne e dimë që ajo deponi është për inerte. Kurse sa i përket mbetjeve shtazore të të cilat hudhen, me siguri Drejtoria e Inspektoriateve me një inspektor të ambientit po e bënë të pamundurën që me mujtë me i zënë ata keqbërës të cilët bëjnë hudhje. Ne për atë arsye kemi kërkuar që e shpjegoja dhe në kërkesën që gjatë hartimit të planit zhvillimor komunal të trajtohet mirë ajo deponi edhe të fillojmë ta funksionalizojmë se si çdo qytetit edhe qytetit tonë i duhet një deponi e inerteve, po jo edhe mbetjeve shtazore, po edhe këto mbetjeve shtazore duhet të gjenden lokacionet ku mund të hudhen. Këtu kërkohet normalisht një inspektim pak më i madh, me mundësitë që e ka Drejtoria e Inspektoriateve. Sa i përket pyetjes e Bajramit rreth udhëkryqit për tranzit. Këtë vërejtje po e marr ose si kërkesë serioze që ta shohim se çfarë mund të bëjnë me shenjëzimim. Semafori nuk e di se mund të na kryen punë apo mund të na komplikojnë, por një prej elementeve që mund të jetë, mund të jetë edhe semafori apo shenja të tjera të komunikacionit të cilat ligji na i lejon. Ishte edhe një pyetje rreth rrugës Lubizhdë-Kabash? do të shohim gjatë vitit 2025 të hartojmë një projekt edhe ta shohim se cilat janë mundësitë buxhetore të komunës ta realizoj. Shukri edhe për rrugën

të cilën ishte kërkesë juaja ka me u marrë shumë seriozisht, ne kemi pasur një projekt për Jetën e Re, po prej vitit të kaluar ka mbetur i pa implementueshëm për shkak që ka shumë probleme pronash. Edhe ajo na ka kufizuar dhe nuk kemi mundur me hapur asnjë procedurë sepse normalisht Drejtoria Shërbimeve Publike aty ku bënë infrastruktura të tilla kërkon një leje prej Drejtorisë e Urbanizmit e nëse pronat nuk janë të qartësuar atëherë nuk kemi mundësi të marrim leje dhe ta procedojmë për me implementuar. Ka qenë projekt i cili vitin e kaluar në muajin nëntor kam pasur disa takime me banorët të atyre lagjeve, të asaj lagjes, mirëpo nuk kanë mundur me gjetë zgjidhje. Nëse kjo rrugë nuk ka me pasur probleme të tilla pronësore, ju premtoj që vitin 2025 kemi me fillu me realizuar. Petriti, rreth rrugës e cila është hapur prej te TA-ja aty që bëjnë qytetarët hudhje të mbeturinave. Me siguri edhe këtu duhet Drejtoria e Inspektoriateve të verifikoj. Fatmirësisht komuna e Prizrenit veç e ka një kontratë rreth vendosjes së kamerave edhe gjatë vendosjes e këtyne kamerave kanë me na ndihmuar shumë që ata keqbërës të identifikohen edhe ta marrin dënimin atë që e përcakton ligji. Sa i përket ujit pijes se Sevil. Ne merremi me Hidroregjionin, kemi kontakte të shpeshta e dimë se qendra e qytetit është problem me furnizim me ujë, nuk ka problem me infrastrukturën ujore të cilët ne e kemi kompletuar si komunë, mirëpo furnizimin me ujë e ka Hidroregjioni. Alban, sinjalizimi vertikal te TA-ja edhe këtë po e marrë, si njohës i mirë i kësaj fushë që je, do ta shqyrtojmë në drejtori me inxhinierat e komunikacionit edhe me siguri që do të intervenohet. Ndriqimi në Kobaj defekt, nëse janë produktet e vjetra, kena me pa mundësinë e riparimit të asaj sa mund të riparohet. Sa i përket rrugës Selajdin Xhezairi, ndriqimi nja 200 metra, për Islam Thaçin. Unë e di që përmbi 80% ajo zonë është e mbuluar, kam dhënë një urdhnesë që prej zonës Nënkalasë deri te spitali të kompletohet me ndriçim. Janë disa rrugica që është problem i qasjes, janë shumë të ngushta edhe pse edhe aty është biseduar me operatorin që të gjejnë mundësi të ndryshme që me mujt me elektrifiku. Do ta shqyrtoj edhe këtë 200 metërshin e fundit. Qartë e kam, kompania del, e verifikon ato që s'punojnë për me i ndërru edhe ma merr mendja se shumë shpejtë kemi me rregulluar. Sa i përket uzurpimit të pronave publike me parkingje, ne e kemi dërguar një vendim të cilin tash e ka marrë ky kuvend rreth formimit dhe ndërmarrjes banesore dhe parkingjeve, e cila kishte me i zgjedhur problemet edhe të parkingjeve në nivel Prizreni, po edhe liftat të cilat Ertani ka kërkesë, kam disa kërkesa të qytetarëve. Kjo kishte me qenë ajo ndërmarrje që kishte me na i zgjedhë këto probleme. Mirëpo ende e dini që për formimin e ndërmarrjes është kompetent një grup ndërmistror të cilët pritet një miratim i tyre, ne nuk kemi përgjigje domethënë që dy muaj ditë. Rrethrotullimi te Bajam Curri? Naxhije, ne jemi tu bë të pamundurën me këqyrë që komunikacioni në territorin e komunës e Prizrenit të zhvillohet pa ndonjë tollovi. Nëse keni qenë në qytete të tjera që besoj që po, Prizreni funksionon më së miri, më mirë se çdo qytet tjetër rreth komunikacionit. Por jemi tuj e bë të pamundurën që me mujt me i funksionalizuar edhe rrethrotullimet tjera dhe me bë ndonjë rrethrotullim të ri aty ku ligjërisht kemi mundësi. Ilir Gashi. Para disa ditësh Ilir deputeti po them se t'uroj me u bë deputet. Ka bë një dezinformim në opinion. Është një trup ndriçues, shtyll ndriçuese e mençur quhet. Ku Drejtoria e Shërbimeve Publike ka hapur një procedurë tenderuese. Dihet që çmimet i përcaktojnë operatorët, jo drejtoria, jo komuna. Nëse nuk e din, eja të japim çfarë sqarime edhe atje, këtë e kam për sqarim të opinionit publik. Kjo shtyllë smart e mençur i ka tetë elemente, edhe tash do t'ju t'ju them ka një, ka një. Kjo dritë kushton meqë është 25.000, çmim furnizues po ju them, 25.000 dollar, e më e shtrenjta është dikund 84.000 dollar. Te ne është tenderuar me 32.000 euro një shtyllë, që është e domosdoshme. Kqyre çka, çfarë funksioni kjo ka, kjo shtyllë Ilir. Jo jo, nuk e din. Shtylla Smart që ju i referoni nuk është thjesht shtyllë ndriçuese, por është një pajisje smart multifunksionale. Për të parë të gjitha karakteristikat e saj, ju referojmë në dosjen e tenderit për të parë të gjitha funksionet e kësaj shtylle. Eja Ilir, eja se merr shköllë. Këto shtyllat e avancuara me shumë funksione si ndriçimi, kamere ekranin display i instaluar, Wireles, mikrostacione, baz 4 G dhe 5G, stacioni i motit që matet, matet pluhuri, ndotja e qytetit që është nisur prej standarteve të Bashkësisë Evropiane. Kësi shtylla është jo vetëm një, po Prizreni ka nevojë minimum për tri shtylla të tilla të mençura të cilët duhet ta përcaktojnë edhe sasinë e lagështisë, edhe të ajrit, edhe

ndotjen. Shko kqyrni nëpër komuna të tjera sa ju kanë kushtuar. Po këtë çmim e ka dhënë operatori. Çmimi furnizues minimum është 25.000 dollar. Llogaritni transportin, TVSH-ja, qa po ta di unë edhe deri te implementimi. Kështu që çmimet i japin operatorët e dini ju shumë mirë ata? Po doni me bë fiskultura, e këto nuk ju shkojnë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtor, të lutem a mundesh të vazhdon me përgjigje? Tu kisha lutur se po presin edhe drejtorët tjerë edhe koha e pauzës gati.

Çelë Lamaj (Drejtor i DSHP-së): Dezinformat, dezinformata është vepër penale. A i shihni këto shtylla? Këto shtylla çmimin a di sa e kanë Ilir? A do me të tregu? Këto janë në zonën historike. Janë në rrugën Shuaip Spahiu në Shadërvan, rrugës për Kala. Janë kërkuar shtylla të cilat janë të miratuara nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore. Nalsia e shtyllave është kërkuar 5 metër. Standardet, të cilat prodhuesit t'i prodhojnë, janë prej ka katër edhe gjashtë metërshe. Në Itali është marrë një konfirmim prej prodhuesit edhe tash tregoj se sa kushtojnë në Itali. Një shtyllë, dy krahëshe në Itali kushton 3.174 euro. Kurse një krahëshe 2.482 euro. Përkrah kostove operatori normalisht me karakteristikat e kërkuara nga njësia e kërkuar i ka marrë në Turqi edhe i ka marrë me çmimet të cilat ju dezinformon ai opinionin. Çmimet i përcakton operatori ekonomik, operatori më i përgjegjshëm. Kështu që kishte me qenë mirë, kishte me qenë mirë Ilir me dalë ti me gjithë ju deputet edhe me dalë në Shadërvan Ilir, me pa çfarë pune e mirë është bërë. Me shkuar Ilir në rrugën për Kala, hec Ilir se është mirë. Shko këqyre rrugën Shuaip Spahiu, rrjetin marimang e kemi hequr. Rruga e tranzitit Ilir u bë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jo jo unë i dhashë vërejtje edhe drejtorit, sapo i dhashë vërejtje. I thashë drejtor vetëm koncentrohu në përgjigje. Drejtor, a mundesh te përgjigjet me u koncentru, të lutem?

Çelë Lamaj (Drejtor i DSHP-së): Shtëpia në tranzitin në ri u largu. Keni mbi 60 km rrugë me asfalt, mbi 60 km rrugë me kubzime, përmbi 120 km kanalizim për këto tre vite, keni mbi 110 km ujësjellës, mbi 3000 fidane. Tash po ju them që brenda këtyne tri viteve mandat janë mbi 300 projekte të implementuara nga komuna e Prizrenit. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Fillojmë me Agim Muqaj se ka që disa herë po e ngrit dorën. Nuk e di replikë, apo? Dhe vazhdoj me Ilirin mundej.

Agim Muqaj (AAK): Kryesuese nuk ishte replikë, por pyetje e kuvendarit Adrit Krasniqi e drejtuar sigurisht se ne të gjithë kuvendarët dhe të gjithë qytetarët janë të interesuar se unë sa mora një informacion për nënat lehona apo për fëmijët që kanë lindur gjatë këtij viti, aplikacioni domethënë është i mbyllur dhe nuk kanë pasur mundësi që të aplikojnë. Unë deshta që sa ishte kryetari këtu ta marrim një përgjigje sepse viti kalendarik veç po përfundon edhe 10 ditë. Kështu që, kush do të na jep përgjigje çfarë do të bëhet për vitin 2024 dhe si do të jenë të drejtat ligjore për këtë vit e mos mbetet për vitin tjetër. Sëpako të jemi të informuar ne dhe gjithë qytetarët. Kush do ta jep përgjigjen? Unë mendova se zyra e kryetarit. Kështu që ju falenderoj.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtori i Financave fjalën e ka.

Sulltan Badalli (Drejtor DEF): Po Agim, se edhe Adriti e ka bërë këtë pyetje. Për nënat lehona sigurisht që do të mbështeten edhe për vitin 2024, besoj që në janar del njoftimi apo thirrja për me aplikuar. Do të thotë në rregull është. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ilir Gashi replikë.

Ilir Gashi (LVV): Drejtor Çelë Lamaj, kryetar Shaqir Totaj, është më mirë, është më mirë me na ndihmuar edhe mua edhe Dafinës, me u bë deputet edhe me shpëstuar prej neve, prej gazepit sesa me na lënë qëtu edhe këto muaj që kanë mbetur e mos me u zhdryp prej qafe. Drejtor, nuk ka nevojë Prizreni për matës të pluhurit, sepse prej pluhurit aktual e kemi marrë edhe alergjinë. Nuk po mundemi frymë e marrë prej prej pluhuri, qaq pastër që që jeni duke e mbajtur. Për bandera nuk ki çka të më folë, për për rrugën e Kalasë sepse unë qarkulloj shpesh. Kqyr banderat e betonit qysh i keni vendosur. A me privat, a vetë, kush q ku i ki, shiko çka e keni bërë rrugën. Përveç, përveç që e keni bërë me kaluar kamionat në të, tash edhe banderat e betonit, që në natyrë brenda qysh keni vepruar. Do thotë për me vepruar keq na ju zgjatim dorën, atë e kemi shumë qartë, nuk kemi dilema për atë punë. Për me shpenzuar buxhetin kot 32.000 euro për një bandereedhe aty tash e pamë edhe u çuditën. Edhe krejt u çuditën, edhe të juajit janë çuditë për ato. Sepse një bazë 4 G ose 5 G ne krejt kemi në shtëpi Wireles, ato kushtojnë 50 euro më të mirat, Nuk kemi diçka me u mburrë me atë send. Një gyp hekri krejt e dimë sa mundet me kushtuar, por jo 32.000 euro! Me çfarë dokument? Mos po printon letra ajo. Për dezinformata e keni prokurorinë, shumë qartë është. Për çdo send aty shkoni depononi aty, na jemi shumë qartë për atë punë. Po që 32.000 euro i keni ndarë për bandera edhe ajo është e qartë si qekjo ditë qysh është e qartë. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Falimendit Ilir. Me radhë, me radhë qysh e keni kërkuar fjalën, Dafina Alishanit. Të lutem Selman mikrofonin. Ju kisha lutur për vëmendje se si që t'i respektojmë edhe kolegë kur të flasin.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit. Shpreh keqardhje prej nivelit të kryetarit. Na uroj vitin e ri, dul! nuk tha, asnjë përgjigje nuk e dha, niveli i tij s'di, s'di unë më çfarë me thënë. Inshallah baba dimri po e bën më mirë këtë kryetar se mbaruan. Kaq arrogant me qenë një kryetar, e kaq i papërgjegjshëm mos me u përgjigj në asnjë pyetje të asnjë kuvendari e me ardhur këtu me na u përgjigj me kot, urime vitin e ri edhe del! Sa i përket drejtorit, drejtor allahile a ta merr mendja që reagoj pa e analizuar secilën hajni që e bëni? A ta merr mendja që flas unë pa analizë? Çka kam ngritur në këtë kuvend të gjitha kanë dalë të vërtetat. Ma herët ka pas, ka dalë, mos u ngut se e kam rendin unë me fol. Kur ka pas tender edhe kur ka pas çmime në njësi, edhe ne e kemi pas njejtë prokurimi, operatori ekonomik ka aplikuar me ato çmime, po e dini çfarë keni bërë ju? A dini që vendin vend s'ja keni lënë asnjë drejtorit? A dini çfarë keni bërë ju mandatin e kaluar për çmimet e nalta? A dini çfarë keni bërë për bllokimet të OSHP-së? Ju thoshit ju jeni të paaftë, ju po vjedhni. Unë po të pyes, qysh ka mundësi 1.700 euro me kushtuar një karrikë? Ti për 900 euro ke reaguar o drejtor, ke bërë konferencë për media, ke dalë i ke thënë hajni e madhe. Çfarë u bë tash në qeverisjen tënde, s'paska hajni a? Sa i përket 32.000 eurove, po ish dashur me dalë këtu me i kërkuar falje qytetarëve, jo me dalë me mburrje. Tre kompani i kam pyetur, të tretve i kam thënë për riza të zotit kallëzomni, merrni marzhën e fitimit më shtrenjtë, veç tregomëni çmimin real çka është qeky produkt. Smartin e ka veç komuna e Prishtinës edhe e Prizrenit, dy komuna të cilët janë kampiona në hajni. Pse? Edhe Smart-in nuk e ka secila kompani? Po vjen këtu po jep informata për Itali. Çfarë ke punë me Itali ti? Ti jeni Kosovë. Ti ke banorë që nuk kanë ujë, ke banorë që nuk kanë mirëqenie e ti po e ke lluksin me shpenzuar 32.000 euro me një shtyllë. Edhe del e thua që gjysma e qytetit është në terr o drejtor. Çfarë s'marti? A budall po do me na bë, a? Gjysma e qytetit, sa asambleistat ta ngritën shqetësimin, rrugën mbas Shtëpisë së Bardhë e ki në terr. A s'po e sheha? Çdo ditë vini këtu. Aa s'po del mbrapa, dil se e ke detyrë, dil se i ke quajtur njerëzit turistat që s'kanë qenë këtu, dil se i keni akuzuar drejtorat e mëhershëm keni thënë nuk po dilni mbas orës 17:00.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dafina të ka kaluar minutazhi i replikës.

Dafina Alishani (LVV): Mos ma ndërpre, të lutna mos ma ndërpre.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): meqë mu drejtove ashtu, ta ndërprej edhe mirë, replika e din që është 1 minutë. Me dorë edhe me atë ton mos mu drejto ashtu.

Dafina Alishani (LVV): A ban mos me ma ndalë?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Nuk bënë meqë mu drejtove ashtu. Kërkova mirëkuptim, ti mu drejtove ashtu. Drejtor fjala për juve është.

Çelë Lamaj (Drejtor i DSHP-së): Dafina, me akuzuar dikë publikisht pa bazë...

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtor tu kisha lutur, nëqoftse filloj me emra dhe me replika do të na zërë nata këtu. Pa emra, jep përgjigje edhe u kry.

Çelë Lamaj (Drejtor i DSHP-së): Shko verifikone dallimi mes kësaj shtyllës edhe karrikave edhe ulëseve të cilat i kemi deneruar brenda kësaj periudhe edhe atyre tujave janë shumë të mëdhaja. Le ta dinë qytetarët se e njëjta ulëse e cila sot është e vendosur në qytet, kanë qenë dy pozicione, njëra me vlerë 11 euro e tjetra 999 të njëjtat karakteristika. Nuk janë dhënë urdhëresë me u bë ajo e 11 eurove se as një shkëmb, asnjë stol nuk mundet me u blerë sot me 11 euro, po kanë dhënë urdhëresë për 999. Ne e kemi një shtyllë të cilat me standarde evropiane kërkohet që duhet ta ketë, po them qyteti i Prizrenit duhet me i pas jo një po tri, po kur të jepet mundësia kanë me u vendos edhe në Bashdarhane edhe te rruga për Gjakovë te rrethrotullimi mendohet aty, po edhe në drejtim të Shqipërisë. Kjo është dallimi mes asaj zhurme të ngritne që thoni që për karrigat e juaja. Kqyrni 11 euro, kqyrni, kqyrni mirë, 11 euro ju shkruan aty edhe i keni qit 999 euro.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dafina replikë sepse ju ka përmend emri, ju të tjerë nuk po e di pse po e kërkoni fjalën. Qetash po i hyjmë kuvendit rend edhe nganjëherë me marrë fjalën. Besomëni po më vjen keq kur po ju them rregullorja na thotë vetëm një herë keni të drejtë me marrë fjalën. Besoni sa po ndjehem keq kur po ju përkujtoj rregullorin, për replikë ok jemi,

Dafina Alishani (LVV): Kryesuese Rregullorja duhet me vlejte për secilin barabartë, kur ka këtu atakime për nivel qendror ndalet mikrofonin. Kur ka këtu sqarime në emër të nivelit qendror.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jo asnjëherë nuk e kam ndalë kur ka qenë minutazhi në rregull. Tash me kalu' minutazhin edhe me kalu me disa çështje të nivelit qendror ose që nuk i përkasin shumë kuvendit, këtu kjo nuk po më duket aspak e arsyeshme. Tu përmend emri përsëri, urdhëro për replikë, e din replika e dytë sa minuta i ka.

Dafina Alishani (LVV): Po çka me kthi replikë? këqyre secili stilin e Shaqir Totaj. Liron sallën kryetari, liron sallën drejtori. Ne po flasim këtu për 32.000 euro shtylla, flet këtu e jep informatën thotë pluhurin po e matë, paramendo pluhurin në po e matka shtylla edhe po i lirojnë sallën. Kryesuese, çka flet asambleisti është vendim i asambleistit. A don me fol për nivel qendror, a don me lidhë temën që ka me ngritur me nivel lokal është çështja e asambleistit. Të lutna na respekto se neve njerëzit na kanë votua këtu për në këto ulëse.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jo jo, e di është çështja krejt te minutazhi.

Dafina Alishani (LVV): S'është për minutazh, kur folet keq për qeverisjen ndërhyri, kur folet normal ose me dashur tash me ju falenderu Shaqir Totës edhe pesë minuta i kam afat, nuk jeni të barabartë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jo jo, nuk është e vërtetë, nuk është e vërtetë jo. Selman unë s'po mbajnë mend që ta përmendi dikush emrin. Nëse ta përmendi emrin, urdhno.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese, po ja që unë po mbaj mend, çfarë me bë tash? Ti ke mendët dika tjetër, te deputetllëku ose te gara. E domethënë, është përsëritur disa herë, po e shfrytëzoj rastin edhe në një herë me ta thënë, unë të kërkova, a je e sigurt që të tjerët nuk flasin më shumë se tre minuta? Tu kisha lutur.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Edhe unë thashë se jam e sigurtë.

Selman Sokolaj (LVV): Të kisha lutur, ki kujdes herëve të tjera edhe mirë e tha kolegja, nuk mundesh absolutisht me na përcaktu neve përmbajtjen e fjalimit, formën, kohën, minutazhin në rregull është, përmbajtjen s'mundesh, ose po i bëjmë po t'i dërgojnë paraprakisht, shtatë ditë afat, i miraton ose i refuzon edhe po shkojmë nga këtu. Rregullorja për Subvencionet, prap po them, po më vjen keq që Drejtori i Financave nuk ke më herët, nuk e di që rregullorja ekziston edhe çdo fëmijë që lind, nëna, prindi, nëna ose baba, prindërit kanë të drejtë me aplikuar për shtesa në një shumë të caktuar minimale, është e përcaktuar në një rregullore edhe në një afat kohorë. Drejtori i Financave po thotë në vitin e ardhshëm bëjmë aplikim për këtë vit! Nëse e zbatojmë rregulloren, qysh e kemi miratuar të gjithë bashkë edhe me antimet e saj, disave nuk ju takon, ju ka humbur e drejta për shkak neglijencës juaj. Se ju ka qenë dashtë me krijuar formular që prindërit me aplikuar, me marrë një fushatë sensibilizimi. Mirëpo po shihet që atë ditë pa vullnetin e juve ka kaluar kjo në kompetencë të asamblesë, është bërë rregullore komunale, nuk është çështje e ekzekutivit edhe po vazhdoni me të vjetrën. Nuk e di në aspektin e ligjshmërisë qysh keni me ja bërë ju. Po s'është që e keni qarë ndonjëherë kokën ju për ligjshmëri. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Zotëri Tajar Susuri fjalën, Islam Thaçi pastaj. Ju kisha lutur sa më shkurtë.

Tajar Susuri (LVV): Faleminderit Kryesuese. Edhe pse s'është Drejtori i Inspektoriateve, edhe drejtori çelë Lamaj iki, deshta me u kyq për deponinë e Zhurit se vërtetë është situatë e keqe. Ajo deponi është e mobilizuar edhe ka një portë edhe dikush e menaxhon atë. Drejtori e dha një përgjigje që kemi me zënë, po presim me zënë me inspektorat personat që po hedhin mbetje shtazore. Me një vendim të drejtorisë apo të kryetarit, kompanisë e cila e mirëmban atë deponi, mundet me u ndaluar këto fenomene të këqija, se vërtetë jemi në hall. Veç për këtë deshta me u kyç. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Zotëri Thaçi.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit Kryesuese. Më vjen keq që drejtori paraprakisht iku edhe nuk po është këtu për të dëgjuar, po faji është i tij për shkak se hyni aty ku s'duhet, do të thotë hapi tema të panevojshme. Po dua me ja rikujtuar drejtorit veç çështjen e ndriçimit publik. Do të thotë ndriçimi publik për këtë qeverisje është thujse i treti për mirëmbajtje është i treti hapet për çdo vit kemi hapje, pavarësisht që kontratat lidhen në afat tre vjeçar. Edhe me dal këtu me më thënë mua që brenda kontratës së lidhur ka mundësi veç 5% nga ai 25% që vjen të dëmtimi i rregullt normal, kjo për mua është veç pasqyr e keqplanifikimit e pastaj edhe keqmenaxhimit të parasë publike. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Zotëri Krasniqi fjalën.

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Unë vetëm deshta pak meqë kolegja Dafina po bën pak politikë, edhe unë desha me bë pak politikë. E përmendi se edhe Prishtina është një komunë që lulzon korrupsioni në atë kuptim tha. Dafina, Prishtina kurrë më mirë s'është qeverisur, projekte të mëdhaja po bëhen në Prishtinë. Merru me Gjilanin me ata me kunata, kunata e jeme, konata jote, me carrok. Kaq pata.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po Dafina, urdhno.

Dafina Alishani (LVV): Nuk e di çfarë e keni këtë siklet kështu po bëjmë politikë, po ne jemi politikan bre, se di çfarë keni problem. Komuna e Prishtinës shihet çfarë suksesi ka me suficicin që e ka. Këta shtyhen mes veti, edhe ky talenti këtu edhe ai atje, janë të njëjtë, i kanë forat e njëjta, qësi të bajatshme, dalin kështu prej sallës, arrogancë me asambleistë. Do duhej të shqetësohesh ti me me qasjen e kryetarit, po s'po di ndonjherë se unë po mendon edhe si politikan e po mendon ndryshe. Kështu që s'ki çka merresh me mua, merru me ekzekutivin edhe me kryetarin.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Kalojmë te Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport të përgjigjet.

Adem Morina (Drejtore i DKRS-së): Faleminderit kryesuese. Të nderuar kolegë drejtor, të nderuar kuvendarë, qytetarë të Prizrenit. Unë do të mundohem të jem i shkurtër në dhënien e përgjigjeve për pyetjet të parashtruara nga kuvendarët. Te çështja Shtëpia e Kulturës në Zhur. Ju e dini që tani me Shtëpia e Kulturës në Zhur, ka më shumë se tre muaj që është deblokuar, ka ardhur një Aktvendim i gjykatës së Apelit. I kemi ndjekur të gjitha procedurat, Shtëpia e Kulturës është tenderuar, është bërë vlerësimi i lëndëve, është shpallur operatori ekonomik fitues, mirëpo aty prej operatorëve dikush ka bërë ankesë, lënda është në OSHP. Është ardhur ekspertiza në favor të komisionit i cili ka bërë vlerësimin e lëndës dhe po presim që shumë shpejtë të vijë edhe vendimi dhe normalisht të fillohet me punime në Shtëpinë e Kulturës dhe të vazhdohet me punime aty. Mirëpo nga ana e banorëve të Zhurit po kemi disa herë probleme, kështu prej individëve të cilët vijnë bëjnë ankesa të ndryshme. Nuk i pëlqen Aktvendimi i Gjykatës së Apelit edhe bëjnë kërcënime të ndryshme. Por megjithatë ne i gjithmonë i vlerësojmë lëndët zyrtare që vijnë nga gjykata dhe do të vazhdojmë me procedurën. Për sa i përket stadiumit në Zhur, ne si drejtori, si komunë kemi kryer të gjitha procedurat që i kemi sipas memorandumit me Federatën e Futbollit edhe punët tona të cilat kanë qenë si komunë i kemi përfunduar. Çfarë ka mbetur aty? Ka mbetur çështja e shtrimit të barit. Ju kam shpjeguar dhe kështu fizikisht kur jemi takuar bashkë Tajar që klubi i Zhurit është shuar, shumë ka pasur problematika sepse edhe UEFA edhe Federata kërkon që aty ku investohet duhet të ketë klub të regjistruar ai vendbanim. Megjithatë kemi bërë thashë një zgjidhje, kemi plotësuar disa dokumentacione që janë kërkuar nga Federata dhe po presim vetëm të bëhet edhe shtrimi i tepihit apo i fushës. Sa i përket pse nuk është futur në listën e laureatëve noti? ne kur i kemi dërguar listat me të gjitha sportet, ka qenë një lëshim te noti. Menjëherë kemi intervenuar, kemi plotësuar, i kemi kërkuar atyre që merren me not, i kemi dërguar e-mail dhe na ka ardhur e-maili pasi ka përfunduar afati kohor i komisionit dhe nga zoti Kujtim Kito drejtor dhe trajner, na ka kërkuar falje në e-mail zyrtar. Ju kërkoj falje ngaqë vonesa ka qenë e imja dhe ne nuk kemi mundur të shpallim për shembull një laureat pa aplikuar. Kjo ka qenë domethënë Ilir si informacion. Normalisht edhe ne e kishim shpallur sepse rezultatet pa diskutim nuk po i mohojmë. Sa i përket pyetjes të hapësirat afër zyrëve të PDK-së rruga Shani Efendia. Zyra pronave e ka dhënë atë hapësirë e cila është dikush duke shfrytëzuar. Mirëpo normalisht ajo është në zonën e mbrojtjes e cila nuk lejon të bëhet intervenime të cilat janë bërë. Ne i kemi njoftuar

organet që ajo që e ka dhënë komisioni, e ka dhënë komisioni që është themeluar këtu në këtë asamblë. Edhe normalisht, normalisht kemi vepruar, kemi tërhequr vërejtjen sepse duhet të tërhiqen të gjitha ato punime të cilat nuk janë në koincidence me ligjin e cila e përcakton për trashëgimimin kulturore që është në zonë e mbrojtur. Për sa i përket subvencionimit të organizatave edhe kulturore dhe sportive, dua të njoftoj që në fillim të vitit kalendarik 2024, DKRS-ja, ka marrë një vendim që kryetari e ka nënshkruar lejimin e 1.1 milion eurove, për subvencionim të vitit 2024. Mirëpo duke pasur parasysh që kërkesat kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha, pastaj edhe me anë të komisionit të ankesave i janë dhënë, janë tejkaluar shifrat, ne si drejtori nga 1.1 milion euro të cilat kanë qenë të planifikuara, i kemi paguar 1.2 milion euro. Kurse shumat përfituese e të gjitha organizatave ka qenë 1.398.000 euro. Kështu që, diku rreth 200.000 euro janë pa paguar ende. Ne po shpresojmë që deri në fund vit të paguhet për të gjitha këto organizata të cilat kanë bërë një punë pa diskutim edhe projektet e tyre do t'i realizojë. Mirëpo në pamundësi nëse ato organizata nuk do t'i marrin këtë vit, menjëherë në momentin e parë që lëshohen mjetet e lira në janar, do të subvencionohen sepse ju takon, ato janë organizata përfituese. Dhe kështu po e them në këtë kuvend me plotë përgjithësi sepse ato mjetet do t'i marrin. Sa i përket defekteve të qendrës sportive në fshatin Medvec, ne me kuvendarin i kemi diskutuar disa herë, ato janë disa defekte të vogla me të cilat ne i kemi njoftuar në këtë rast operatorin ekonomik i cili i ka kryer punimet dhe po shpresojmë që shumë shpejtë edhe ato defekte të vogla të cilat janë aty që e shfrytëzon edhe komuniteti edhe shkolla do të eliminohen. Kështu që, ju faleminderit edhe për pyetjet e shtruar.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Drejtori Edin Shehu fjalën e ka.

Edin Shehu (Drejtor i DA-së): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për të gjithë. Pata një pyetje prej Egzonës për lirim nga pagesa për personat me aftësi të kufizuara. Padyshim Egzona komuna e ka një rregullore e cila është votuar së fundmi edhe me të përfunduar kjo mbledhje, unë do të mirrem me këtë çështje, do t'i pyes zyrtarët, Udhëheqësin e Gjendjes Civile se ku është, ku ka mbetur si procedurë. Bajrami për muzeun në Landovicë. Drejtoria e Kulturës e ka një kontratë e cila merret me mirëmbajtjen e lapidarëve. Do të konsultohemi së bashku me drejtorin Ademin edhe do të këqyrim se cila është mundësia çka mundemi me bë në atë muze. Ndërsa Sevili për sa të punësuar të komunitetit janë bërë në këtë vit kalendarik. I rekomandoj që të këtë pyetje t'ia parashtojë Zyrës së Personelit. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Kemi drejtorin e Shëndetësisë në radhë.

Simir Krasniqi (Drejtor i DSH-së): Faleminderit Kryesuese. Të nderuar drejtorë, të respektuar kuvendarë, përfaqësues të mediave. Sa i përket pyetjes së Tajar Susurit se kur do të pajiset Qendra Kryesore, Qendra e Mjekësisë Familjare në Zhur me një auto ambulancë? Këtë e kemi në plan dhe shumë shpejtë pra do të pajiset me auto ambulancë. Ja përcjell Tajarit. Kurse pyetja e dytë, pyetjes së Egzonës, se a keni pasur thirrje për subvencionim të prekurve me kancer? Po Egzona, thirrja ka qenë prej muajit shkurt deri më 15 nëntor. Ne e dimë që vitet e fundit kemi një rritje të të prekurve me kancer, por nëqoftëse shkojmë me përqindje, pra mund të themi që çdo vit 10 deri 20% shkon duke u rritur aplikimi i të prekurve dhe ne i kemi kryer të gjitha pagesat në bazë të aplikimit se si kanë aplikuar, flas pra të gjithë këta të sëmurë me kancer. Ndoshta jemi edhe komuna e vetme mund të themi këtu e falenderojmë edhe kryetarin që me një shumë me nga 400 euro, pra i subvencionon. Disa komuna të tjera ndoshta me kosto shumë më të vogël. Kjo kategori meriton edhe më tepër por kaq janë mundësitë buxhetore të Drejtorisë Shëndetësisë që t'i financojë këta të sëmurë me kancer. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Drejtori për Bujqësi fjalën, pastaj drejtoresha Ramize Sinanaj.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR-së): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për kolegët drejtor, asambleistët, media, shoqëri civile, qytetarë të nderuar. Po i përgjigjem pyetje së Petritit, i cili tha që nga komisioni ka dërguar një e-mail që unë e kontestoj që plotësisht është gabim. Asnjë e-mail në adresën time mos ndoshta gabim në Prishtinë e ke quar rastësisht e ke harruar, se këtu jemi në Prizren. Edhe që Qemali. Qemali parashtroi një pyetje për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore të cilat kanë ndodhur në kohën e fundit. Po Qemal, unë po dua më shumë si informatë me ju dhënë fermerëve që nga momenti i ndodhjes së fatkeqësive natyrore që ndodhë fermerët kanë afat shtatë ditë që t'i adresojnë kërkesat e tyre për dalje në terren të komisionit për vlerësimin e dëmit. Të gjitha kërkesat që na kanë ardhur, komisioni i kryen me kohë të caktuar edhe në mënyrë profesionale. Sot e keni edhe pikën e shtatë që fatkeqësitë natyrore që kanë ndodhur nga janari deri në nëntor, janë sot në votim tek ju, ndërsa këto dëme të tjera që kanë ndodhur, komisioni besoj që e ka kryer punën e vetë, varësisht prej kërkesave që i kanë bërë fermerët. Unë po apeloj edhe njëherë që fermerët në afat prej shtatë ditësh t'i adresojnë kërkesat e tyre për vlerësimin e dëmeve pavarësisht prej të cilave. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Drejtor. Petriti ka replikë, e ka gjetur e-mailin më duket.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Po është është në orën 8:44 në mëngjes bexhat.bytyqi@rks-gov.net. Kjo është e-mail që kam gjetur edhe në web-faqe të komunës. Nëse t'i lexon najkush e-mailat edhe nuk tregon, unë nuk kam faj këtu.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR-së): Personalisht unë vetë i shikoj e-mailat dhe nuk ndodh asnjë e-mail për tre vite që mos me ja kthyer dikujt. Ndoshta edhe me vonesë por ja kthejmë gjithsesi. Dhe sidomos ty si komision bile mos i trego këto dobësitë që asnjëherë s'jeni kanë kurrë në zyre te ne. S'di çfarë komisioni jeni, çfarë funksioni keni.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Drejtoresha Ramize fjalën.

Ramize Sinanaj Shala (Drejtoreshë e DES-së): Faleminderit kryesuese. Të nderuar drejtor, të nderuar kuvendarë. Është bërë një pyetje nga Dafina. Po Dafina unë mbasi jam në dijeni po ta jap përgjigjen. Te shtëpia prapa Vectorit ka qenë komisioni, është formuar një komision brenda disa drejtorive për shtëpitë të cilat paraqesin rrezikshmëri, i njëjti komision e ka bërë raportin, ja kemi dërguar palës edhe i kemi sugjeruar që me i ndjekur hapat e mëtejme. Të jemi të qartë se Drejtorja për Emergjenca dhe Siguri vetëm e bënë vlerësimin e dëmit ose vlerësimin të asaj shtëpie që paraqet rrezikshmëri. Mirëpo për pjesën tjetër japim rekomandime të cilës drejtori duhet me ju drejtu, edhe sa jam në dijeni se pronari i asaj shtëpie ka qenë në zyre dhe kemi bisedu. Ata kanë probleme familjare dhe janë në kontest gjyqësor. Kështu që është problem përmes gjithë këtë çështje. Ne si drejtori, si komunë e kemi kry.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtoreshë. Po Dafina urdhno.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit drejtoreshë. Nëse ka rrezikshmëri, a nuk do të duhej që komuna me marrë përgjegjësi rrënimin, sepse tash aty ka shumë hisedarë edhe unë jam e informuar edhe nëse e presim gjyqin, unë kam frikën se e keni parë qysh është gjendja, nëse ka një rrezikshmëri të lartë ose së paku me siguru që mos me pasur ndonjë demtim mbi ndonjë njerin andej.

Ramize Sinanaj Shala (Drejtoreshë e DES-së): Po Dafina, ka qenë edhe inspeksioni, i kanë vu aty edhe masat, po mendoj shiritat, mirëpo ata i kanë hequr për arsye për të cilat ata po insistojnë me çdo mënyrë me rrënuar atë shtëpi. Mbas raportit tonë ata duhet me aplikuar te Drejtoria e Urbanizmit për leje për rrënim. Kështu që unë nuk e di se çfarë hapa kanë ndërmarrë. Përndryshe ne i kemi vendosur edhe shiritat, mirëpo i kanë hequr, nuk i kanë lënë aty.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtoreshë. Atëherë po ju falenderoj të gjithëve anëtarëve për kontributin në këtë pikë, gjithashtu edhe drejtorat. Po vazhdojmë me pikën e katërt.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Zotëri Gursel, fjala për juve.

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Faleminderit Kryesuese. Përshëndetje për të gjithë. Është obligim ligjor i çdo Kuvendi Komunal që deri më 31 dhjetor të votohet lista e pronave komunale. Kjo listë është sikurse e vitit të kaluar me disa...

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju kisha lutur për pak vëmendje, ju lutem për qetësi.

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Kjo listë është sikurse e vitit të kaluar me disa ndryshime dhe plotësime që kanë ndodhur në bashkëpunim me disa drejtori komunale të cilat i kanë pasur kërkesat e tyre. Pas miratimit të kësaj liste, sipas ligjit nga ana e kuvendit dhe konfirmimit të ligjtërisë nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal, lista e pronave komunale për çdo vit publikohet në web-faqen e komunës. Andaj për kërkoj që kjo listë të votohet nga ana juaj. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Gursel. A dëshiron dikush me marrë fjalën apo të shkoj me qëndrimet e shefave të grupeve? Po fillojmë me Lëvizjen Vetëvendosje. Kush don me e marrë fjalën për subjektin politik? Po Dafina Urdhno.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit. Paraprakisht unë vetëm do të doja edhe ja ta bëjë një pyetje para se të flas në emër të grupit. Sa prej pronave nuk kanë kontrata? sepse në Komitetin për Politikë dhe Financa na e thatë që ju sigurojmë informatat. Informata e vetme që e kam pranuar nga ju është pronat komunale, lokalet me adresat, gjë që është në rregull. Po sa prej pronave nuk kanë kontrata? e dini për çfarë është fjala. Domethënë janë qiramarrës të cilët kanë aplikuar me çmim të lartë dhe nuk kanë mundësi tash me i paguar. Edhe këto lokale të cilët kanë qenë të zbrazta a janë futur në këtë listë edhe mirë është me i informuar edhe kuvendarët të tjerë që nuk janë në Komitetin për Politikë dhe Financa. Një ndryshim të cilën e kemi në këtë pikë. Çfarë janë ndryshimet të cilat ju i keni sjellë këtu?

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Faleminderit Dafina. Të gjitha domethënë shfrytëzuesit e pronave komunale janë në web-faqen e komunës me adresa, me sipërfaqe, me kontratë, me numër të kontratës, janë të gjitha atyre edhe qiraja mujore domethënë të gjitha janë kontratat e atyre. Po atë listë mundem me ja dërguar edhe juve. E dyta, lokalet të cilat nuk janë të shfrytëzuara janë në këtë listë edhe ato. Unë juve edhe në Komitetin për Politika e Financa edhe këtu po ju them se prej lokaleve pronë komunale janë pesë lokale, domethënë te ndërtesa e Globalit edhe Libraria Siprinti janë domethënë pa kontratë ato, pse s'ka pasë kërkesa nga shfrytëzues. Edhe pyetja tjetër

ndryshimet. Disa ndryshime, unë si thashë në fjalën hyrëse timën, domethënë ndryshimet i bëjnë prej drejtorisë përkatëse. Këtu e kemi një do ndryshime çka janë kërkuar prej Drejtorisë Urbanizmit për shembull nga kadastrale 1413, kemi ngastrën katasale 1409. Domethënë atë listë çka na ka sjellë Drejtoria e Urbanizmit edhe Drejtoria e Shërbimeve publike, ne i kemi verifikuar ato kontratat. Nëse janë ato ngastra kadastrale më falni, nëse janë në listë domethënë mirë, nëse nuk janë në listë, ne e kemi shtuar atë listën edhe i kemi futur. Domethënë këto kërkesat, lista ndryshon varësisht prej drejtorive përkatëse të cilat i kanë projektet e tyre dhe i parashikojnë për vitin 2025.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit. Drejtori i Kulturës thotë, Sektori i Pronës e ka dhënë një leje të ish-zyrat e PDK-së, T'lutna, nëse mundesh me na informuar çfarë është çështja e saj.

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Se drejtori, ky drejtori shumë gabim e ka, su kan dashur me folë. Drejtor atë leje atë leje komisioni, domethënë komisioni formohet. Dafina, prona komunale munden me u dhënë afatshkurt, afatgjatë, po edhe më pak se një vjet. Më pak se një vjet jepet domethënë me rregullore të cilën e keni miratuar ju. Simpas rregullores formohet një komision prej tre anëtarësh edhe ai komision tre anëtarësh, çka nuk është asnjë anëtar i komisionit prej Sektorit të Pronës, është prej Drejtorisë Urbanizmit, Drejtorisë së Inspektorateve edhe Shërbimeve Publike, domethënë ai me propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit ai e ka dhënë, domethënë nuk ka shkue procedura përmes Sektorit të Pronës.

Dafina Alishani (LVV): Kanë filluar dezinformatat edhe live me na dalë tash. Drejtor, ju thatë Sektori i Pronës, Sektori i pronës po thotë jo. Po jo, është çështja e një pronë e cila është në qendër të qytetit edhe tash edhe live po duhet me të ndejt gati se je duke na dezinformuar. Singerisht po të lus ma mos, ndali këto dezinformata. Kolegë të dashur, a tha drejtori Zyra e Pronës? A tha Sektori i Pronës? Qe Sektori i Pronës po thotë jo.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të lutem Dafina, ka mu përgjigjur drejtori, drejtori merr shënime, se kemi filluar me i marrë prononcimet e subjekteve politike.

Dafina Alishani (LVV): Po qysh me votuar një pronë për të cilën nuk jam e informume? Unë nuk po kuptoj.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po mirë, ke të drejtë edhe mos me votu.

Dafina Alishani (LVV): Por kam të drejtë mu informu, kam të drejtë edhe mos me u dezinformu, kam të drejtë mos me u gënjy midis secilit kuvendar këtu. Mjaftë bre ma, singerisht mjaftë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Vazhdojmë me Partinë Demokratike. Drejtor mandej ke me dhënë përgjigje se jemi te shefat e grupeve.

Adrit Krasniqi (PDK): Ne si Parti Demokratike e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Falemminderit. Lidhja Demokratike?

Qemal Krasniqi (LDK): Meqëse është interes i përgjithshëm që këto prona të jipen në shfrytëzim me qera, kur dihet se në shumë lokalitete shumë prona komunale, keqpërdoren, janë uzurpuar e tjera e tjera, është mirë që edhe ne kështu si grup i kuvendarëve do ta mbështesim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, vazhdojmë me AAK-në.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit. Meqë edhe në KPF kam kërkuar prej Gurselit edhe tash është sqaruar. Unë kërkoja që një pronë të jetë e përfshirë aty, nuk mujtta me identifikuar me numër të parcelës, po Gurseli pak a shumë e din për ku bëhet fjalë. Nëse veç munden me futë pastaj, unë e kisha përkrah, është edhe kërkesë e qytetarëve. Kam edhe një pyetje për Gurselin. Qysh do të procedohet këto pronat e parkingjeve që do të jepen në shfrytëzim? A do të shkojnë përmes zyrës tuaj apo qysh do të procedohet më tutje? Faleminderit.

Gursel Skenderi (Sektor i Pronës): Faleminderit. Ky është projekti i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike e parashikon se ku kanë me qenë parkingjet. Edhe kur t'i përcaktoje ku vendparkingjet, atëherë shkon procedura si e dini ju përmes kuvendit edhe domethënë ato parkingjet edhe komisionit çka formohet nga ana juaj. Po bartësi i projektit është Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po vazhdojmë me Nismën.

Shukri Quni (NISMA): Faleminderit kryesuese. Unë pata një pyetje për pronat që janë nëpër fshatra. Tash e keni përpara edhe ju kolegë kuvendarë. Është emërtimi pronë shoqërore e Kuvendit Komunal, numri i parcelës, zona katastrale, sipërfaqja. A ka mundësi me na sqaruar pak më tepër këto nëpër fshatra e kam fjalën? Për këto pronat që janë nëpër fshatra, se në qytet kemi njohuri rreth këtyre por këtu shumicën i kemi sherjanë, nuk e dinë qysh shkojnë pronat nëpër fshatra. Këto po du me e ditë pak më qartë.

Gursel Skenderi (Sektor i Pronës): Po, faleminderit. Edhe pronat nëpër fshatra kemi shumë emërtime të ndryshme, domethënë të mirat e fshatit, dobrosel e këto. I nderuar, të gjitha këto, edhe pse kanë emërtimet e ndryshme, pronar është Kuvendi Komunal. Se fshati, nuk mundet me qenë person juridik, çka mundet me marrë të drejtat dhe obligimeve. se personat fizike edhe personat juridikë marrin drejtat, detyra dhe obligime. Fshati nuk është person juridik, por është Kuvendi i Komunës, domethënë pavarësisht emërimit çka është, pronar është Kuvendi i Komunës.

Shukri Quni (NISMA): çka do të ndodhë me ato pronat që ka ndërtime, për shembull në ato pronat shoqërore nëpër fshatra ka ndërtime. Tash mos të hi unë detajisht, por ka, jeni të njoftuar edhe ju. E a do të jepen edhe ato në shfrytëzim apo do të jenë, do t'i legalizojnë dikur më vonë? Se goxha ka probleme këtu, këto janë probleme më të mëdhaja këtu kanë me qenë. Ne do ta përkrahim mendoj partia Nisma por unë po të tregoj që nëpër fshatra këto janë goxha, edhe çfarë është më e keqja lajmërojnë qytetarët për shembull për uzurpim të pronave të pronës shoqërore të Kuvendit Komunal, edhe inspektoriati shkon e lajmëron, në fakt i thotë atij që x personi ka ardhur më ka treguar se unë s'e di ku është ky vend. Dhe nuk është mirë kur lajmëron dikush për një uzurpim të një pronë shoqërore, nëse i dilni zot si komunë, atëherë duhet me e mbrojtë me të vërtetë ose lëni të gjithë atëherë le t'i uzurpojnë ato edhe le t'i shëndrojnë prona të veta private. Po më kupton besoj për çka jam kah flas? Se këtu kemi para vetit çdo pronë që është e Kuvendit Komunal në nivel të komunës së Prizrenit, për fshatra po flas. Çka do të bëhet me ato? A do t'i qitni edhe ato me i marr? Apo do të jesi qashtu qysh i kanë shfrytëzuar deri më tani. Ose të jemi të barabartë të gjithë, edhe unë ta uzurpoj një pjesë, s'bëhet nami tash, tan kjo Kosovë.

Gursel Skenderi (Sektor i Pronës): Vërtetë se çka nëpër fshatra edhe për shkak të numrit të inspektorave ka pak, po gjithmonë, gjithmonë domethënë ne edhe më herët zotëri Shukri e kemi pasur këtë çka në fillim, në fillim kur të ka uzurpime kryetari i fshatit duhet me lajmëruar menjëherë, është ai nëpërmes Drejtorisë së Administratës menjëherë me i lajmëruar inspektorat edhe me e ndalë. Se mandej, të folim realisht sipas ligjit. Qysh po thotë zotërii Shukri me lajmëruar

inspektorin edhe kurqja, se kryetari i fshatit i cili është i zgjedhur përmes Drejtorisë së Administratës, ai e di në fshat cila është pronë komunale, cila është pronë private edhe ai duhet me në hap qetash, se çka tha zoti Shukri Quni është në ligji mandej mos të flasim qetash këtu tash, se nuk është e drejta e jeme, se nëse ndërtohet objekti, është ligji shumë asi, nëse ligji atëherë vlera e objektit është shumë më e madhe se vlera e pronës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Mirë, a po vazhdojmë? Kemi mbetur tek KDTP.

Levent Bus (KDTP): Edhe ne si KDTP, e përkrahim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. YHTP-në se kemi, NDS jo. Vakati?

Sead Arifi (VAKAT): E përkrahim edhe ne Koalicioni Vakati.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. edhe SDU nuk është këtu. Dikush tjetër prej anëtarëve të kuvendit? Petrit Hoxhaj, Qemal Krasniqi dhe Selman Sokoli.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Kam një pyetje kështu. Gjatë dhënies në shfrytëzim të lokalit, a keni vërejtur që ka qira mbi qira në lokale dhe a e lejon ligji? Faleminderit.

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Ne nuk kemi vërejtur, ligji nuk e lejon, domethënë ato që janë zyrtarisht, pagesën e bëjnë te Drejtoria për Ekonomi e Financa edhe ne faturat zyrtarja që ka asi, domethënë në emër të atij personit që lëshohet qiraja, në emër atij personit i cili është fituesi i lokalit qysh na ka dërguar komisioni.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Qemal Krasniqi fjalën, pastaj Selman Sokoli.

Qemal Krasniqi (LDK): Pyetje për zotëri Gurselin. Në këto lista numri, do të thotë numri i parcelës po dihet. A janë të evidentuara objektet, institucionet komunale që janë të ndërtuara në ato parcelat? Mos që në këto lista se ipni me qira është e ndërtuar ndonjë shkollë ose diçka tjetër e del. A i keni verifikuar mirë? Kaq.

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Faleminderit zotëri Qemal. Pavarësisht, pavarësisht edhe nëse janë, edhe nuk janë, domethënë nuk është, nëse është në qat listë, nuk do të thotë se patjetër duhet me i zhvilluar procedurat. Por nëse zhvillohen procedurat, hapi i parë domethënë duhet me qenë në qat listë. Domethënë, pavarësisht nëse janë apo nuk janë nuk do të thotë se duhet me i dhënë. Po, nuk do të thotë edhe pse janë në listë nuk do të thotë se patjetër na duhet me i dhënë me qira.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Selman Sokolaj fjalën.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. Nuk e di pse saherë në këtë Kuvend Komunal flitet për prona, ai Kryetari i Komunës Shaqir Totaj, nuk është këtu. Ai ka një siklet me prona edhe po besoj që ai e di për çka jam duke folur. Te propozimi i kryetarit, zotëri Gursel, këtu sigurisht e keni shkruar ju, po flitet edhe për listë të veçantë të pronave. Ne kemi pasur në 30 nëntor të vitit të kaluar një pronë të madhe komunale që është dhënë duke i anashkaluar këto procedura. Dhe kemi pasur edhe fjalimin që e kam pasur, edhe ankesën që e kemi bërë, pikërisht jemi thirrur në këtë. Domethënë ju mbas një kohe vetë po e verifikoni që keni bërë shkelje. Kjo është mirë për me vështirë shënim. E dyta kolegja Dafina pyeti, atë pyetje pata edhe unë pyetje mirëpo nuk e di a ka marrë kjo përgjigje por unë s'mora përgjigjen në pyetjen që e dëgjova. Kemi pasur një ankand për

dhënie në shfrytëzim ose me qira të lokaleve ose pronave të komunës. A ka fitues të ankanit që nuk kanë nënshkruar kontratë? Për shkak se në ankand kanë ofruar ndoshta çmime shumë të larta, mos me shkuar dikush tjetër. Edhe kur vjen momenti me nënshkruar kontratën, qiraja mbase është shumë e madhe, ai e ka vlerësuar vetë. Mirëpo a ka fitues të ankandit që nuk ka nënshkruar kontratë për qira me komunën e Prizrenit? Faleminderit.

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Nuk ka. Edhe unë e thashë edhe njëherë, domethënë në web-faqe i keni të gjithë, të gjithë nënshkruesit e kontratave me lokale ku gjendet, me qiranë mujore, madje janë të dhënat edhe numri i kontratës, afati i kontratës këto të gjitha janë aty.

Selman Sokolaj (LVV): Jo lokalett që janë duke dhënë që i kanë ata, po lokalet që i kanë në posedim edhe që kanë qenë fitues paraprak të ankandit. Ju jeni duke thënë diçka që në rregull të gjithë ata që kanë kontrata. Zotëri Gursel, veç pak për me sqaruar. Nëse ja vnon menën pak ka dallim kjo. Ju po thoni se të të gjithë shfrytësuesit e lokaleve që kanë kontrata janë të publikuara. Unë të thashë kështu. A ka fitues të ankandit që nuk kanë nënshkruar tani kontratë e ndërkohë janë duke e shfrytëzuar pronën?

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Nuk ka.

Selman Sokolaj (LVV): Më herët në këtë kuvend ka pasur pretendime që ka. Ju po thoni që nuk ka. Në rregull, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtor urdhëro. Drejtori për Kulturë.

Adem Morina (Drejtor i DKRS-së): Faleminderit kryesuese. Unë dua vetëm ta sqaroj në pyetjen e parashtruar më herët, me vullnetin më të mirë e pata, sepse u bë pyetje në lidhje me te ish subjektit e PDK-së apo Shani Efendija. Objekti i Shani Efendisë është nën menaxhimin e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe deshta ta jap vetëm si informacion, gaqë s'ka të bëjë ajo me qëllimin tjetër se kush e ka dhënë pronën në këtë rast për menaxhim, a ka dhënë komisioni apo zyra e pronave. Unë e aludova, e thashë që Zyra e Pronave ka mundësi ta di më mirë, sepse është edhe një komision i cili i ka dhënë ato lokale në menaxhim edhe pak rëndësi ka cili është komisioni. Por unë e dhashë vetëm si sqarim, sepse kemi dalë në vend të ngjarjes, e kemi parë, e kemi parë që është tejkaluar ajo me të cilën i përket hapësirave ku është zona e mbrojtur dhe kemi lajmëruar në këtë rast që duhet të bëhet ndërhyrje dhe kjo ishte qëllimi. Për pjesën tjetër, normalisht që është komisioni i cili merret me atë pjesë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Zotëri Gursel, më sa e pashë një propozim konkret ke nga zotërii Bajram, për një parcelë për të cilën për momentin nuk e ka numrin e asaj. A jemi në rregull që mund të futet në këtë listë?

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Po mundet.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë, po prona vendi, pra bashkë me propozimin e zotëri Bajram po e hedhim në votim në qoftëse nuk ka edhe dikush tjetër. Prezent jemi 23 anëtarë. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Ju kisha lutur dorën pak më lartë në mënyrë që t'i numërojmë votat. 18 jemi për, katër kundër dhe 1 abstenim, Atëherë miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Ju falenderoj të gjithëve. Shkojmë me një orë pauzë dhe ju kisha lutur për shkak të pikave të rëndësishme që i kemi sot për vetëm ta përfundoj, zotëri Gurcel, të lutem. Do ta jap fjalën. Janë pika shumë të rëndësishme të cilat duhet t'i miratojmë sot. Ju kisha lutur që të gjithëve që të ktheheni pas pauzës edhe të vazhdojmë me punët e kuvendit. Zotëri Gursel një fjalë e ka.

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Më falni, kuvendarë të respektuar. Pika e rendit të ditës është për Reçan. Unë kam me shkuar në aeroport, nëse bënë edhe këtë me mirëkuptim, ju kisha kërkuar ndjesë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju kisha lutur për hir të respektit edhe moshës, meqë e paska urgjente këtë udhëtimin. Ju kisha lutur të ulenii nëpër vende. Atëherë po kalojmë edhe te pika e pestë,

Pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të objektit pronë komunale për raste të veçanta.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po zotëri Gursel?

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Faleminderit edhe ju falenderoj edhe njëherë për respektin. Ky propozim është që të jepen në shfrytëzim policisë së Kosovës kati parë i objektit të zyrës së gjendjes civile në fshatin Reçan. Propozimi është që të jetë afati domethënë 10 vjeçar, kurse mënyra e shfrytëzimit është pa kompensim. Domethënë, objekti i zyrës së gjendjes civile vetëm kati i parë, kurse katin përdhesë prapë zyrtari i gjendjes civile ka me shfrytëzuar. Kjo është domethënë për raste të veçata.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po. Faleminderit. A ka dikush diçka? Zotëri Thaqi, Seadi pastaj.

Islam Thaqi (LVV): Faleminderit kryesuese. Meqënëse nuk është hera e parë që kuvendi komunal bashkëpunon me policinë e Kosovës duke u munduar që t'i del në krah kërkesave të tyre. Mua vetëm më intereson informacioni se Policia e Kosovës a e shfrytëzon lokalitetin e dhënë po nga ky kuvend komunal në qendrën historike të Prizrenit do të thotë bëhet fjala për lokalet. Do të thotë a ka në shfrytëzim? E faleminderit.

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): po ka.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Sead Arifi fjalën.

Sead Arifi (VAKAT): 2.12.14 - 2.12.23 min Pjesa 1. Gursel një pitanje po se se na ka kancelaria u dva sprata je ide prvi sprat ili drugi sprat policijezyrtari i gjendjes që Po, falla puno.

Gursel Skenderi (Sektori i Pronës): Katin e parë ka me e shfrytëzue policia, kurse katin përdhesë prap ka me e shfrytëzue zyrtari i gjendjes civile.

Sead Arifi (VAKAT): Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A dëshiron dikush tjetër me e marrë fjalën? E hedhim në votim edhe këtë pikë. 25 jemi prezent. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Unëanimisht, ju faleminderit shumë. Atëherë shkojmë me një orë pauzë edhe kthehemi në ora 13:35 minuta.

Pjesa e dytë;

Pika e gjashtë;

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2025.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Pra, si çdo vit edhe këtë vit ne duhet ta formojmë një grup punues për hartimin e planit të punës dhe të gjitha subjektet politike duhet ta propozojmë nga një emër. Siç e dini këtë grup punues si kryesuese e këtij grupi punues do të jem unë. Ndërsa po shkojmë me propozimet duke filluar prej subjekteve politike. Vazhdojmë me lëvizjen në Vetëvendosje?

Dafina Alishani (LVV): Lëvizja Vetëvendosje e propozon Islam Thaqi.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Falimendit. PDK?

Adrit Krasniqi (PDK): PDK-ja e propozon Egzona Hoxhaj.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. LDK?

Qemal Krasniqi (LDK): Propozojmë zotërin Hodaj.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. AAK?

Bajram Kastrati (AAK): e propozojmë Agim Muqaj.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Nisma?

Shukrije Berisha (NISMA): e propozojmë Shukri Qunin.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. KDTP? Meqë janë vetëm nga një anëtar është zoti Levent Bush. YHTP? Se jeni bë dy ju.

Ertan Simitçi (YTHP): 1.03 – 1.29 minuta. Teşekkürler başkan. Bugünden itibaren yenilikçi Türk Hareket Partisi Prizren Belediyesi meclisi iki meclis üyesi ile Türk toplumunu ve halkımızı temsil edecektir. Bu vesileyle de Sevil Liman Kazas hanımefendi çalışma grubunda yer alacaktır.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit shumë. Edhe partitë të tjera NDS është Merdzan Osmani, VAKAT Sead Arifi edhe SDU Admir Alilji. Pra këta janë emra të cilët do ta përbëjnë këtë grupin punues. Pra edhe njëherë shkojmë me Lëvizjen Vetëvendosje Islam Thaqi, PDK Egzona Hoxhaj, LDK Haziz Hodaj, AAK Agim Muqaj, Nisma Shukri Quni, KDTP Levent Bushi, YHTP Sevil Kazai, NDS Merdzan Osmani, VAKAT Sead Arifi dhe SDU Admir Alilji dhe siç e thashë edhe unë si kryesuese e këtij komisioni. Po a keni diçka me diskutuar rreth kësaj pike? Në qoftë se jo po e hedhim menjëherë në votim. 23 jemi present, kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Unanimisht, ju faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika e shtatë.

Pika e shtatë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e raportit të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Për prezantim do të jetë drejtoresha Ramize.

Ramize Sinanaj Shala (Drejtoreshë e DES): Faleminderit kryesuese. Unë në pika të shkurta do t'ju raportoј për këtë raport. Pra siç e dini nga viti 2022, AME-ja, Agjencioni për Menaxhimin Emergjent, ka kërkuar që në nivel të komunave të kemi një komision të përbërë prej disa drejtorive për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Pra në vitin 2024, në këtë raport janë përfshirë vetëm dëmet të cilat janë të shkaktuara nga bujqësia, ku total dëmi është bërë për vitin 2024 është 632.229.79 euro. Kështu që kisha kërkuar prej të gjithë juve që ta votoni këtë raport për arsye se është në favor të qytetarëve. Po ashtu unë kur kam marrë pjesë në komisionin për Politikë dhe Financa, anëtarët e këtij komisioni kanë kërkuar një përgjigje se çka ka ndodhur me dëmet që janë shkaktuar në vitin 2023. Unë i kam dërguar e-mail zyrtarëve të AME-së nuk më kanë dërguar përgjigje me shkrim, mirëpo në bazë të telefonatës për të cilën unë e kam pasur me ta, më kanë thënë se komuna e Prizrenit edhe komisioni në nivel komunal, edhe në komisioni në nivel qendror e kanë kryer punën e tyre dhe e kanë dërguar në ministri. Kështu që ju kisha lutë të gjithë kolegëve, ata të cilët kanë mundësi që me komuniku me zyrtarët në qendër atje në mënyrë që këto dëme me u paguar. Janë disa komuna, është e vërtetë që janë paguar disa komuna, fatkeqësisht që komuna e Prizrenit nuk janë paguar këto dëme. Faleminderit. Për më shumë informata rreth këtij raporti, është edhe drejtori i Bujqësisë pasi që krejt këto dëme janë bërë nëpërmes drejtorisë së atyre. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Po zotëri Qemal e ka kërkuar fjalë.

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit drejtoreshë. Komuna e Prizrenit edhe në vitin 2023 edhe 2022 është ballafaquar me vërshime. Përveç që ka pasur dëme në bujqësi, ka pasur dëme edhe në infrastrukturë, në objekte të institucioneve të ndryshme, ka pasur edhe në amvisni familjare. Është fakt që në disa komuna janë paguar ato dëme, komuna e Prizrenit fare nuk ka marrë, është fjala për amvisni. Sa i përket dëmeve në bujqësi është e vërtetë që janë realizuar ato pagesa, mirëpo këtu po qalojmë. Vazhdimisht disa vite kur ka pas kështu fatkeqësi natyrore, zjarre e vërshime shpesh herë sepse jemi këtu në këtë kuvend e kam ngritur atë problematikë sepse ne zona e Përdrinisë kemi lumin Topllua i cili di të bëjë dëme të jashtëzakonshme, dëme të mëdhaja, si në bujqësi por edhe në shtëpi, në infrastrukturë të ndryshme. Ne asgjë, askush, as ju këtu si Prizren, por edhe nga niveli qendrorë asnjëherë nuk na është thënë që do të përfitojnë dëmtuesit. Ju kisha lutur që herën tjetër, ishallah do Zoti që mos të kemi asnjëherë, mirëpo të jeni pak më aktiv, në këtë drejtim dhe të punoni pak më shumë sepse me të vërtetë shpesh here dëmtuesit nuk kanë ditur se në cilën derë me trokitur, nuk kanë ditur ku me trokitur për ato dëme që ju kanë bërë. Gjithashtu ne edhe këtë vit të 2024, kemi pasur dëme aty këtu edhe në zjarre. Ka qenë temperatura, siç e dimë, kanë qenë temperatura të mëdhaja dhe ka pasur dëme për shkak të zjarrit. Po edhe aty nuk janë marrë në konsideratë dhe nuk është bërë në atë drejtim asgjë. Kërkoj që këto tjera herë, inshallah nuk ndodhë, po të jeni pak më aktiv ju si emergjencë, por njëkohësisht edhe drejtoritë tjera që kanë të bëjnë rreth kësaj çështje. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Krasniqi. Diikush tjetër prej anëtarëve të kuvendit? Po. Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. Kam një pyetje për komisionin ose për drejtorin se të gjithë këto persona të cilët janë në këto listë, a janë të regjistruar si fermer? A kanë NIFA si

fermer që paraprakisht me ditë sepse NIFI e tregon se është infermer apo nuk është. Tjetra është që pse nuk janë paguar deri tash këto sepse edhe ka, gjatë analizimit të listës kam vërejtur që disa persona janë me çmime të njëjta, do të thotë qysh ka mundësi fermerët me çmimet të njëjta do të janë vlerësuar dhe unë mendoj që arsyeja pse nuk është duke u paguar për këtë, kur them unë mendoj do të thotë është i imi mendimi im, që këto lista janë të fryra me vlera dhe qeky është shkaktari pse nuk është duke u paguar. Ndërsa në momentin kur po fryhen listat, atëherë nuk po përfitojnë me të vërtetë që ata që kanë pasur dëme. Nuk po du me hy me i përmend me emra me të gjitha sepse i njohim të gjithë fermerët e komunës së Prizrenit edhe pse veç e më komunës së Prizrenit që dy vjet nuk është duke ju paguar kjo? A nuk po i dërgoni listat në adresën e duhur apo po i refuzojnë shkaku sepse janë të fryra? Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Petrit. Dikush tjetër prej anëtarëve të kuvendit? Në qoftë se nuk ka atëherë drejtoresha ka përgjigje pastaj edhe drejtori.

Ramize Sinanaj Shala (Drejtoreshë e DES): Po, dashta me ju përgjigjur pyetjes së Qemalit. Qemal, unë fillimisht me qëllim e ceka se neve nga AME-ja na ka ardhur e-maili për me formuar këtë komision. Qëllimi i këtij komisioni ka qenë që ky komision me bë vlerësimin e dëmit për të gjithë qytetarët kur dëmi shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera. Nuk ka të bëjë me pyetjen e zotërisë që po thotë për, a janë të regjistruar, domethënë për të gjithë qytetarët. Ky komision ka dalë në terren edhe i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve pa dallim, me afate ligjore. I njëjti raport është pranuar nga komisioni në nivel qëndror, niveli qëndror e ka dërguar të njëjtin raport në qeveri, aty është ajo pengesa që nuk kemi arritur. Nuk qëndron edhe fakti që është fryrë kjo listë ose janë fryrë shumat, nuk qëndron edhe ajo. Po shpresojmë që ndoshta tash janë edhe zgjedhjet edhe mundet me u bë kjo pagesë. Mirëpo unë ju thash në vitin 2024, janë përfshirë vetëm dëmet e bujqësisë për arsye dëmet në ekonomi nuk kemi mujt, i kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat, por këtu tash kemi ngecur sepse nuk kemi një çmimore. Të dy komisionet janë në bashkëpunim se si me bë këtë vlerësim të dëmit. Për arsye po e marr një shembull, nëse një shtëpisë ju ka bë veç një, jo kulmi mundet me u ndërtuar, por te fasada ju ka dëmtuar veç me një pjesë. Si me vlerësuar atë fasadë ku për me renovu qatë pjesën ku e ka prishur breshëri, duhet komplet shtëpia. Domethënë kemi pengesa teknike. Për atë punë për vitin 2024, vlersimet në ekonomi ende nuk janë bë. Ndërsa ky raport është vetëm për vlerësimin e dëmeve në bujqësi për të gjithë qytetarët pa dallim nëse janë të regjistruar apo jo, sepse menaxhimi emergjent na kanë kërkuar nivel komunal. Besoj që jam e qartë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtoreshë faleminderit. Drejtor, fjala për juve.

Bexhat Bytyqi (Drejtor i DBZHR-së): Unë desha vetëm Qemalit shkurt me i kthyer një përgjigje edhe Petritit. Qemal, nuk duhet me i përzi kompetencat e nivelit lokal me nivel qëndror. Është komisioni në nivel lokal dhe në nivel qëndror. Në nivel lokal komisioni e kryen muaj me ju garantuar që shumë me saktësi edhe shumë janë të përgjegjshëm për me e kryer këtë punë edhe kryen në afat rekord. Ndërsa Petriti aludoj në atë që listat janë të fryra. Petrit nuk ka mundësi me u fryrë lista sepse çmimorja është prej Ministrisë. Ne nuk e japim çmimin, ne e përcaktojmë vetëm vlerën e dëmit sa është bërë, vetëm e llogarisim me çmimin që Ministria e ka bërë edhe na del çmimi, nuk ka mundësi ne me i fry. Pse janë dy fermerë me çmime të njëjta, ka mundësi me pas kulturën e njëjtë, sipërfaqen e njëjtë, në të njëjtin vend. Edhe ajo nuk ka ndryshe qysh del matematika. Kjo është, edhe tjetra qeto informatat ti je duke i lypur prej neve duke qenë këshilltar i ministrit. Me të vërtetë po më vjen shumë keq prej teje që po i pyesin këto gjëra kur duhet me u interesuar në nivel qëndror. Niveli qëndror duhet ti me ngritur zërin pak. Sinqerisht po them, duhet me ngritur zërin atje pse Prizreni s'është pagu, jo mua me më pyet. Se ne punën tonë e kemi kryer, e kemi dërguar listën në qeveri. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. A dëshiron dikush tjetër me marrë fjalën rreth? Po zotëri Qemal përsëri?

Qemal Krasniqi (LDK): Drejtor, ju thatë që komisioni po i kryen punët në afat rekord, apo? Nuk e kam të qartë që ai komisioni për vlerësimin e dëmeve, ai kryen vlerësimin e dëmeve vetëm në bujqësi apo edhe në infrastrukturë edhe në amvisëria familjare, se s'e kam të qartë. Sa komisione janë? A është një komision? A duhet me qenë dy komisione apo cila? S'e kam të kjashtë.

Bexhat Bytyqi (Drejtor i DBZHR-së): Qemal, drejtoresha ju sqaroj shumë mirë. Është një komision në nivel komunal, i përfshirë prej disa drejtorive, ku një anëtar e ka edhe Drejtoria e Bujqësisë. Po, e ka, pesë drejtori janë të përfshira, në nivel komunal është. Edhe ju tregoj edhe drejtoresha pse s'janë kryer në amvisëri për arsye të mungesës së çmimorës se si qysh me e llogaritë. Ndërsa ne në bujqësi e kemi çmimorën, është fikse edhe në bazë të asaj ne i kryjmë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po Petrit, urdhëro.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Drejtor, unë e di që këtyre ifermerëve po ju thuhet që nuk është i paguar Ministria e Bujqësisë. Ne krejt e dimë që këto nuk i paguan Ministria e Bujqësisë, është një departament i veçantë në Ministrinë e Punëve të Brendshme që i paguan këto dëme dhe ish kanë mirë që me cek të fermerëve, sepse ata gjithmonë, jo vetëm mua, por edhe të tjerëve ju shkruan pse nuk po i paguan ministri këto dëme. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dikush tjetër? Në qoftë se nuk kemi atëherë po e hedhim në votim. Prezent jemi 22 anëtarë, kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës. 21 për, 0 kundër, dhe 0 abstenim, atëherë miratohet edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Ju faleminderit të gjithëve.

Pika e tetë siç e dini është larguar nga rendi i ditës për sot. Kalojmë te pika e radhës.

Pika e tetë:

Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore 2024-2026.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po zonja Kumrije Bytyqi fjalën e ka.

Kumrije Bytyqi (DPMS-QPS): Faleminderit e nderuara kryesuese. Përsëritet drejtor të drejtorive, kuvendarë të kuvendit dhe media. Atëherë unë sot këtu jam në rolin e koordinatores komunale kundër dhunës në familje dhe në baza gjinore. Kjo marrëveshje është realizuar me 1 mars 2024 dhe si rezultati i kësaj marrëveshje është edhe plani i veprimit kundër dhunës në familje dhe bazave gjinore. Pra, ky plan është bazuar duke i mbrojtur të gjitha format e dhunës fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, është bazuar dhe në jetësimin e parimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët njëjtë si burrat dhe gratë. Gjithashtu, qëllimi kryesor është edhe funksionalizmi i këtij mekanizmi, ky mekanizëm ka qenë në funksion edhe më herët, mirëpo qëllimi i saj është se është zgjedhur edhe koordinatori komunal dhe është një përpjekje shumë e madhe në mes të të gjitha institucioneve dhe qëllimi kryesor ka qenë që komuna të ketë një plan veprimi, pasi që deri më tani nuk kemi pasur plan veprimi për mbrojtjen e dhunës kundër grave dhe burrave. Pra, të gjitha këto veprimet janë marrë në kuadër të kësaj marrëveshjes e nënshkruar nga kryetari i komunës e Prizrenit, nënshkruar nga të gjitha institucionet relevante ku janë organet e drejtësisë, janë shërbimi i sprovues, Qendra për Punë

Sociale, janë drejtoritë komunale dhe gjithë këto përpjekje janë bërë në kuadër të mbështetjes së OSBE-së. Jemi bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Parandalim dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Baza Gjimore, Konventa e Stambollit për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje në përgjithësi. Strategjinë kombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave si dhe në standartet ndërkombëtare të procedurave standarte të veprimit të cilat edhe çdo ditë i kemi para vetes dhe i zhvillojmë të gjitha procedurat. Pra, synimi kryesor është rritja e akordimit e koordinimit më efektiv në bashkëpunim me të gjitha veprimet të cilat i marrin institucionet.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Zonja Kumrije, tu kisha lutur, e kisha kërkuar edhe mirëkuptimin e kuvendarëve, meqë ka disa ditë që e kemi këtë material nëpër dorë, a ka nevojë me shkuar shumë gjatë? A po pajtoheni që?

Shkelzen Kastrati (PDK): Po pajtohem, në rregull është.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit shumë për prezantimin, s'po dojmë me të munduar më shumë, vetëm në qoftëse kanë anëtarët e kuvendit ndonjë pyetje. Atëherë në qoftëse nuk dëshironi me e marrë fjalën, po e hedhi në votim. Prezent jemi 22 anëtarë. Kush është për që të miratohet kjo pike e rendit të ditës? Ju lutem dorën ta mbani pak më gjatë derisa t'i numrojmë. 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenim. Atëherë miratohet edhe pika e nëntë e rendit të ditës. Ju falenderoj të gjithëve. Kalojmë te pika e 10.

Pika e nëntë:

Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po urdhëro Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Në emër të grupit të Lëvizës Vetëvendosje, pasi që nuk kemi marrë përgjigje prej kryetarit edhe morëm disa urime për vitin e ri. Ne lirojmë sallën sepse nuk na ka respektuar neve, andaj ju dëshirojmë juve seancë të këndshme edhe urime vitin e ri kryetar.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Shkojmë pak pauzë edhe kthehem menjëherë

Pjesa e tretë;

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jemi te raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024. Kryetar, fjala për juve është.

Shaqir Totaj (Kryetar i Komunës): Përshëndetje prapë sot për herë të dytë. Ju falenderoj edhe një herë për durimin edhe për kthimin në seancë, këta që u kthyen, ata që nuk janë kthyer, është zgjedhja e atyre. Kemi kaluar një vit, konsideroj të ketë qenë i suksesshëm edhe sot e kemi një raport gjithë përfshirës apo përmbledhës për punët që kemi bërë si qeverisje lokale gjatë vitit 2024. Normal që kemi pasur edhe sfida, po kemi pasur edhe të arritura, tek e fundit sfidat njëkohësisht janë edhe mundësi edhe duhet me i falenderuar krejt stafin, domethënë qeverinë lokale, po përveç asaj edhe asamblenë sepse pa punën e suksesme të asamblesë s'kishim mundur shumë gjëra me i përfunduar edhe me i finalizuar. Do të vazhdojmë të lëvizim përpara në drejtim të përmbushjes së premtimeve. Sa për informacion për ata që nuk e dine, në bazë të analizës së Institutit GAP diku deri më tani diku 60% të premtimeve që na i kemi dhënë janë realizuar po janë realizuar edhe në 140 projekte të cilat hiç nuk i kemi pasur premtuar në fushatën elektorale, por ato kanë ardhur si rezultat i komunikimit gjithpërfshirës që e kemi pasur me struktura të llojllojshme me pjesë të

ndryshme të territorit të komunës së Prizrenit me komunitete, me të rinj, me të vjetër, me OJQ, me gazetarë, me nxënës, me krejt. Pse s'i kemi premtu, se s'i kemi ditur që ekzistojnë? Në komunikim të gjithë përfshirës e kemi marrë vesh që janë edhe ato nevoja, kemi pasur mundësi edhe i kemi realizuar. Kemi pasur disa prioritete, po ajo kryesorja gjithë përfshirëse është përmirësimi i kualitetit i jetës, domethene përmirësimi i kushteve të jetesës për të gjithë banorët e territorit të komunës së Prizrenit. Normal ka pas investime në infrastrukturë, ka pas investime në jetën kulturore, përmes subvencioneve kemi përkrahur jetën kulturore dhe aktivitetet sportive. Ka pasur shumë investime edhe në arsim edhe në shëndetësi dhe pothuajse në gjitha lomitë edhe pothuajse në gjitha pjesët e territorit të komunës së Prizrenit. E dimë që nevojat e qytetarëve apo banorëve të territorit të komunës së Prizrenit proporcionalisht janë më të mëdha se mundësitë tona, edhe për këtë arsye gjithmonë duhet në sistem të caktimit të prioriteteve me selektuar ato projekte të cilat mund t'i realizojmë apo mund t'i financojmë duke u bazuar në mundësitë tona buxhetore sepse e dimë që edhe pse e kemi më të mëdha se disa komuna të tjera në një farë mënyre janë të kufizuara. Po ja fillojmë me sa takime kemi mbajtur për shembull. Kemi mbajtur takime javore me drejtor, kanë qenë të hapura për media. Takime me ambasadorë, zëvendësambasadorë, delegacione nga ambasadat, kemi qenë prezent nëpër media, kemi pritur kryetarë të qyteteve dhe shumë kryetarë të tjerë, kemi pritur në takim përfaqësues të OJQ-ve, qytetarë dhe me të cilët kemi iniciuar bashkëpunime. Jemi zgjedhur komuna, ndër katër komunat më transparente në Kosovë me numër të barabartë të pikëve me tre komuna të tjera, mirëpo komuna më e madhe transparente për shkak të vëllimit të punëve dhe vëllimi i dokumentacionit që ne e kemi, konsiderohet që është më e vështirë me bërë transparent te një komunë më e të madhe ose një komunë më të vogël, kështu që është një meritë e shtesë e atyre personave, konkretisht të Hazizit që kanë punuar këtë pikë edhe i kanë përmbushur standardet. I kemi nënshkruar diku 30 memorandume edhe dy tri aneks memorandume për bashkëpunim. Nuk po i lexoj të gjitha sepse të gjitha i keni të listuar në raport. Kemi marrë mirënjohje nga disa organizata për korrektësi në çështje edhe në bashkëpunim ku po them nga disa po e përmendim më së pari USAID-in po e përmendi GIZ-in, po e përmendi UNDP-në. që na kanë falenderuar si ekip e cila ka qenë e gatshme për me bashkëpunuar dhe me dhënë një kontribut në realizimin e projekteve të cilat kanë dalë si rezultat i bashkëpunimit me këto agjensione. Te Zyra për Komunikim me Publikun, pikërisht domethënë është një zyre e cila ka bërë një punë të mirë që e përmenda pak më herët edhe si rezultat ne kemi dalë komuna më transparente në Kosovë edhe kemi marrë mirënjohje nga KDI-ja. Këtu ka shumë detaje të cilat janë të listuar. Por në funksion të kësaj po dua me përmendur se kemi pasur takime të rregullta me shumë organizata jo-qeveritare. Kemi pasur takime të rregullta si rezultat i një marrëveshje të nënshkruar me OSBE-në me disa organizata jo-qeveritare, kemi pasur takime të rregullta me media, kemi pasur takime të rregullta me qytetarë, me grupe të ndryshme të interesit që janë një indikator shumë i mirë i faktit që nuk kemi kurrgjë për me mshef, por jemi shumë transparent. Zyra e Auditimit të Brendshëm e dimë që ka bërë një punë shumë të mirë. Edhe kemi këtu disa pika ku përmendet rishikimi periodik dhe vjetor i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditorit të brendshëm. Domethënë raporti i auditorit ka qenë i pakualifikuar, mirëpo ka pasur disa të gjetura dhe disa rekomandime, edhe zyra e Auditorit të Brendshëm në bashkëpunim me kabinetin e kryetarit ka iniciuar adresimin e të gjeturave në funksion të përmirësimit e më të performancës financiare si indikator shumë relevant i performancës së përgjithshme të komunës. Janë realizuar këto detyra audituese. Zbatimi i procedurave lidhur me identifikimin, evidentimin, klasifikimin, barazimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë, rregullsia e procesit të planifikimit dhe inkasimi i të hyrave, rregullsia e lidhur me kalkulimet e detyrimeve dhe grumbullimit të hyrave nga tatimi në pronë, menaxhimi i shpenzimeve për mallra, rregullsitë në procesin e subvencionimeve dhe të transfereve në Drejtorinë e Buqësisë, janë dhënë dy rekomandime, pajtueshmëria me procesin e prokurimit, menaxhimi i shpenzimeve për investime kapitale, detyra audituese. Duke u bazuar në planin e punës për vitin 2024, janë paraparë shtatë detyra audituese, auditime me qëllim të përcaktimit nëse veprimet dhe rezultatet e proceseve të audituara janë në

pajtim me ligjet. Rezultatet kryesore të arritura gjatë periudhës 1 janar 30 nëntor 24, domethënë 7 auditime deri më 30 nëntor 2024 janë realizuar gjashtë detyra audituese, raportet të përfunduara, raportet periodike dhe vjetore për Kryetarin e Komunës, për Komitetin e Auditimit dhe njësinë qendrore harmonizuese. Domethënë po i lexoj ato të cilat ju veç i keni në raport krejt. Zyra e përfaqësuesit ligjor, zyra e përfaqësuesit ligjor vepron sipas ligjeve në fuqi duke mbrojtë të drejtat e institucionit gjatë periudhës raportuese kjo zyre ka pranuar 2138 lëndë të reja. Prej lëndëve të pranuar janë përpiluar 1606 përgjigje në padi. Ka përgatitur katër padi të inicuar nga komuna. Janë bërë 1737 ankesa, 524 prapsime, 13 mjete të jashtëzakonshme, 13 propozime për caktim të masës së sigurisë, 29 fjalë përfundimtare të dorëzuara me shkrim. Afërsisht janë përgatitur 127 parashtresa, njoftime, kërkesa, përgjigje në masë e kështu me radhë. Ndërsa përfaqësime në gjykatë për mbrojtjen e interesave të komunës diku 554 seanca kanë qenë. Zyra Ligjore gjatë periudhës janar-dhjetor ka përgatitur 495 vendime dhe 35 autorizime. Statistikat sipas muajve. i keni të shënuar me krejt komplet, mos t'i lexoj për shkak të kohës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po kryetar, sa të mundesh më shkurtë që edhe juve t'ju kursejmë për arsye se i kemi pasur materialet.

Shaqir Totaj (Kryetar i Komunës): Te zyra e Burimeve Njerëzore, menaxhon konkuret dhe kontratat e punonjësve të institucionit. Gjatë vitit 2024 ka realizim këto aktivitete. Domethënë konkurse, numri i konkurseve të shpallura për në punë në Shërbimin Civil për periudhën e raportimit është 34, prej të cilëve 12 konkurse kanë përfunduar me sukses dhe janë plotësuar me staf, 11 të dështura pa kandidatë të suksesshëm dhe 11 janë në procedurë. Numri i konkurseve të shpallura për nëpunësit të shërbimit publik 23, me gjithë se të kërkuar 166 vende të lira, prej të cilëve shërbyes publik një konkurs me 3 vende të lira përfunduar me sukses, 3 të rekrutuar, në shëndetësi 14 konkurse, në arsim 8 konkurse e kështu me radhë. Detalet, këto janë faktikisht shënime statistikore të cilat i keni krejt të regjistruara në raport. Te Zyra e Prokurimit në vitin fiskal 2024 janë zhvilluar gjithsej 195 procedura të prokurimit të cilat përfshihen punë, shërbime, furnizime të vlerave të vogla, të mesme, të mëdhaja si dhe janë zhvilluar 55 procedura të vlerave minimale. Janë nënshkruar gjithsej 236 kontrata prej tyre, 27 kontrata janë të vitit fiskal 2023, 15 aneks-kontrata në procedurat e prokurimit të vitit 23-24 dhe 236 kontrata të nënshkruara janë të vlerave minimale. Vlera totale e kontratave të nënshkruara për vitin fiskal 24 deri me para përpilimit të këtij raporti është 22.222.242.45 euro. Në procedurat e prokurimit për vitin fiskal janë dërguar gjithsej 74 kërkesa për rishqyrtim. Janë ngritur në sistem 135 vendime të autoritetit kontraktues. Në procedurat e prokurimit për vitin fiskal janë paraqitur gjithsej 89 ankesa për 66 është bërë zgjidhje lidhur me ankesën ndërsa 23 ankesa janë në proces të pritjes së vendimit të OSHP-së për procedim të mëtejshëm. Domethënë OSHP-ja edhe 23 raste i ka pa i zgjidhë. Zyra për Çështje të Pronës kryesisht statistika. Puna e çështjeve të pronës është e lidhur me organe të tjera në kuadër të komunës e Prizrenit si avokaturën publike komunale, Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorinë e Inspeksionit, si dhe organet jashtë komunës së Prizrenit, shërbimin policier të Kosovës e të tjera. Në periudhën janar-dhjetor pranë sektorit të çështjes së pronës janë pranuar gjithsej 577 lëndë, prej të cilëve në afatin e paraparë ligjor, janë shqyrtuar dhe janë aprovuar 503 lëndë, janë refuzuar 58, ndërsa 16 lëndë janë në procedurë e sipër. Tash çfarë lloj lëndë janë këto? I keni të regjistruara. Zyra për Integritet Evropian, ka realizuar këto aktivitete. Gjatë periudhës raportuese është bërë sigurimi i implementimit për zbatimin e obligimeve të komunës nga agjenda evropiane për veprime që ndërlidhen me komunën dhe raportin sipas kërkesave të MAPL-së. Ka implementuar me sukses projektin Roma, aktet nga Këshilli i Evropës, kurse kryetari i komunës është zgjedhur kryetari më miqësor ndaj Romëve, që është një arritje e krejt komunës, jo veç ajoja. Edhe gjatë kësaj periudhe kjo zyre ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në përpilimin e rregulloreve, planeve, strategjive komunale e ka qenë pjesë e komisioneve sipas kërkesave dhe legjislacionit në fuqi. Zyra për Komunitete dhe kthim ka pasur disa lloje të aktiviteteve,

shpërndarja e pakove ushqimore higjienike, shpërndarja e druve të zjarrit, bashkëpunim me OSBE-në, është shpallur thirrja publike për hapjen e konkursit për grant e për krijimin e të ardhurave ku kanë aplikuar 40 persona sipas marrëveshjes me projektin Integra, bëhen takime me gratë dhe vajza të reja për riatdhesim, aktivitet për riintegrim. Gjatë periudhës raportuese janë bërë gjithsej shtatë takime të komisionit komunal për riintegrim. Kjo zyre deri më tani ka lëshuar gjithsej 419 vërtetime për shkëputje jashtë vendit. Edhe kjo zyra i përcjell rregullisht ngjarjet fetare dhe kulturore. Reportet sipas drejtorive. Te Drejtoria e Administratës ka vazhduar me punë të renovimit të objekteve të komunës për të lehtësuar dhe përmirësuar punën e zyrtarëve komunal. Gjatë vitit 2024 kemi renovuar këto hapësira. Renovimi i objektit të zjarrfikëve, renovimi i hapësirave të Drejtorisë së Urbanizmit, furnizimi me gjeneratorë për nevojat e drejtorive, renovimi i tërësisht i tualeteve në katin e parë të objektit të administratës. Në vazhdimësi është intervenuar në sistemin e ngrohjes qendrore. Investimet kapitale për memoriale, ndërtimi i pllakës përkujtimore për familjen Batusha, vazhdimësi i memorialit në fshatin Krushe e Vogël dhe përfundimi i ndërtimit të varrezave të martirëve në fshatin Krushe e Vogël. Po ashtu drejtoria ka mbështetur organizimin e epopeve të ndryshme. Statistikat nga puna e sektorit e gjendjes civile janë numrat të cilët i keni të regjistruar, por është e rëndësishme me përmend numrin total të certifikatave që është 172.704, një numër jashtëzakonisht i madh. Edhe totali i shërbimeve me procedurë është 801. Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave implementon punët sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, si përpirimi i buxhetit, implementimi, përpilimi i qarkoreve buxhetore mbledhja e të hyrave, procedimi i pagesave e kështu me radhë. Në bazë statistikave të cilat nuk janë të finalizuar deri më tani diku përmbi 90% e kemi shpenzimin e tërësishëm të buxhetit. Edhe diku rreth 94-95% jemi për sa i përket realizimit të planit të hyrave buxhetore për këtë vit. Edhe kjo drejtori po ashtu ndërlidhet me raportin auditori gjeneral edhe ka bërë punë të mirë për sa i përket adresimit të rekomandimeve në drejtim të përmirësimit të tyre. Drejtoria e Shërbimeve Publike gjatë vitit 2024 ka filluar rreth 37 projekte të reja dhe ka vazhduar implementimin e projekteve që kanë vazhdimësi nga vitet paraprake e që janë rreth 50 projekte. Gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar 29 kontrata të reja në vlerë rreth 18 milionë euro. Projektet kryesore, kapitalet e përfunduara dhe në implementimi e sipër janë nja dy faqe këtu, apo tri faqe po kanë edhe po me ja nis me i lexuar krejt këto shkon goxha gate, por kujt i intereson i kanë krejt të shkruar edhe mundeni detalisht me i lexuar. Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor. Projektet kryesore të drejtorisë gjatë vitit 2024 janë rehabilitimi i kulmeve dhe korridorëve në objektet e banimit kolektiv, sigurimi i kushteve optimale për banorët për përmirësimin e pamjes urbanistike të lagjeve, hartimi i planit zhvillimor komunal dokument shumë me rëndësi me të cilin drejtoria do të përcaktojë zonimin e zhvillimit të pjesëve urban edhe rurale dhe hartimi i planit rregullues urban për zonën e veçantë Parku i Biznesit. Pasqyra tabelore mbi gjendjen e vendosjes së landave në sektorin e urbanizmit. E keni këtu këtë tabelën. Drejtoria e Inspektoratit vepron në bazë të ligjeve në fuqi në disa sektore, në ndërtim, sektorin komunal, sektorin e tregut. Sektori i ndërtimit është ai i cili ndoshta ka pasur sfida më së shumti, kryesisht është në terren dhe merret me këto aktivitete. Ndërprerja e ndërtimeve pa leje, objekteve afariste, banimit kolektiv, shtëpi banimi, depo, objekte të karakterit të përkohshëm e kështu me radhë, kontrollimi sistematik i objekteve me leje apo respektohen lejet, mos ka tejkalime e kështu me radhë. Gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë veprime për rrinimin të objekteve pa leje, objekteve që janë pjesë e projekteve komunale e të tjera. Rënimet e realizuara, përmenden disa si demontimi i objekteve me karakter të përkohshëm, konstruksione metalike të ndërtuara pa leje ndërtimore nga organi kompetent, me kërkesën e Drejtorisë e Pronës është bërë lirimi i hapësirës në lagjen Bajram Curri, me kërkesën e Drejtorisë së Pronës për lirimin e hapësirës shoqërore, rrënimi i objektit të kjo është në rrugën Bajrakli në Bazhderhana është rrënu ky objekti këtu afër neve, rrënimi i objektit në Landovicë e kështu me radhë. Sektori komunal që vepron në Drejtorinë e Inspektoratit ka realizuar këto aktivitete. Lirimi i hapësirave publike të cilat në mënyrë të ndryshme shfrytëzohen nga bizneset, domethënë janë larguar qadrat me mekanizëm, kjosqet, pengesa të ndryshme, reklamat, kyqjet ilegale e kështu me radhë. Inspektorët

komunalë kanë vazhduar punën e tyre me inspektimin e qendrave tregtare, inspektimi i banatoretve, kiosqeve, asgjësimi i mallrave jo-ushqimore, asgjësimi i produkteve kozmetike, edhe të gjitha këto të tjera që janë të regjistruara këtu në raport. Drejtoria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, i ka pasur investimet kryesore kapitale të realizuara gjatë vitit. Rehabilitimi i kanaleve të ujitjes dhe pastrimi i kanaleve kulluese, projekt që është realizuar në zonat kadastrale në Piranë, Vlashnjë, Poslisht, Grazhadnik, Kabash i Hasit, Krushë e Vogël. Me q'rast janë rehabilituar 15 m kanale ujitëse dhe 8 km kanale kulluese. Rehabilitimi i rrugëve fushore në disa zona, Piranë, Medvec, Korish, Krushë e Vogël, Zhur, Kobaj, Nashec, Atmaxhë, Randobravë e të tjera. Edhe ndërtimi i strehimores së qenëve që nuk është realizuar për shkak të problemeve me lokacionin, mirëpo kontrata në ndërkohë është nënshkruar pasi që ky raport është përpiluar edhe ka filluar projekti për çështjen e adresimit të qenve endacak. Projektet kryesore me bashkëfinancim, ngritja e serrave 25 serra, ngritja e pemishteve me pemë të imta 27 fermer, ngritja e pemishteve me pemë të imta, dredhza, mjedra në vazhdim, ngritja e pemishteve me pemë arnore 17 fermer, furnizimi me mekanizëm bujqësor 205 fermerë e kështu me radhë. Gjatë vitit 2024 janë subvencionuar sektorë të ndryshme të blegtorisë. Subvencionimi i sektorit të bletarisë, akuakulturë, subvencionimi i qumështit, subvencionimi i deleve, projekte të tjera të kësaj drejtorie të realizuara janë 8 projekte të tjera përveç këtyre që i përmenda. Drejtoria për Gjeodezi dhe kadastrin ka pranuar 22.712 kërkesa në kuadër të sektorit të gjeodezisë dhe kadastrit. Kontrata të shitblerjes, kontaktat e dhurimit, aktgjykimet, aktvendimet, lista poseduese, kopje e planit e kështu me radhë. Nga këto lloje të lëndëve, në qoftëse i ndajmë në numra, i kemi 21.690 kërkesa janë miratuar. 518 janë në proces, 374 janë refuzuar, 84 janë pezulluar, 47 janë anuluar për shkak të gabimeve teknike. Aktivitetet më të rëndësishme janë legalizimi. Janë regjistruar 236 vendime të Drejtorisë së Urbanizmit. Shpronësimet ku pjesa kryesore, domethënë prekti kryesor është të varrezat e qytetit që është bërë shpronësimi edhe janë kryer kushtet që me kaluar atje. Edhe objekti i ish ndërmarrjes Liria, të cilën e përmendëm pak më herët që është bërë rrënim i tij. Drejtoria e Kulturës, Rinisë e Sportit. Projektet kapitale më të rëndësishme janë një 18 i paska. Po unë po i përmendi disa më të rëndësishme. Renovimi i Shtëpisë së Kulturës Xhemajli Berisha, memoriali i Xhavit Elshanit-Leopardi, përrurimi i memorialit Porta e Liris në Has, ndërtimi i fushës futbollit, fusha sportive, renovimi i Shtëpisë së Kulturës në Zym, restaurimi i kullës Cikaj-ve në Gjonaj, e paska plot këtu. E për vitin e ardhshëm e di që është në plan Shtëpia e Kulturës në Zhur. DKRS-ja, ka organizuar ngjarje kulturore sportive për ditën e festave dhe ngjarjeve të veçanta. Organizimet kryesore janë manifestimi i festës së 17 Shkurtit, ndarja e mirënjohjeve për klubin futbollistik të Hasit, Lidhja Shqiptare e Priznit, koncerti i dita e çlirimit e kështu me radhë. Festivalet më të rëndësishme Hasi Jehon, Shoqëria e Kulturo-artistike Agimi, festivali i fëmijëve fluturat, kënga qytetare, festivali folklorik për fëmijët, Rock Blues festivali, Doku Festi, këto janë që sponsorizohen nga komuna. Edhe këtu është një listë e sponsorizimeve, këtë do ta kalojmë se janë shënime statistikore krejt. Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës. Aktivitetet më të rëndësishme të realizuara gjatë vitit 2024, vlen me theksuar këtu se drejtoresha apo drejtoria ka marrë një mirënjohje prej Ministrisë së Arsimit që në një farë mënyre është treguesi i punës së suksesshme. Aktivitetet më të rëndësishme janë përgatitja e planit zhvillimor të arsimit për vitin periudhën kohore 2025/2027, është hartuar strategjia për sigurinë në institucionet edukative arsimore, është punuar drafti-plani i veprimit që së shpejti duhet të jetë në dëgjim publik. Së bashku në vitin 2024 ka bërë trajnime të mbi 500 mësimeve, 20 shkolla janë furnizuar me pajisje teknologjike, në bashkëfinancim me Kosovo Makers, 43 shkolla janë pajisur me nga një robot edukativ e kështu me radhë. Gjatë vitit 2024 DKA-ja ka implementuar shumë projekte kapitale, disa nga ato kanë përfunduar, disa janë në proces të implementimit. Disa nga më të rëndësishmet janë: ndërtimi i objektit të ri të shkollës në Pllanjanë, ndërtimi i objektit të ri të shkollës Gjergj Kastrioti në Mazrrek, ndërtimi i shkollës Krushe e Vogël, Aneksi në Vermicë, salla e edukatës fizike shkollën Haziz Tola, ndërtimi i sallës së edukatës fizike Famtmir Berisha në lagjen Bajram Curi, Aneksi i shkollës në Romaje të Hasit, e kështu me radhë. I keni të shkruar me krejt. Gjatë vitit 2024 janë planifikuar dhe pesë projekte

të tjera, hartimit të projekteve të ndryshme për DKA, mirëmbajtja e sistemit e ngrohjes qëndrore në institucionet arsimore të komunës, rregullimi dhe mirëmbajtja e ambientet në oborret të shkollave të komunës, lymja e brendshme dhe të jashtme të shkollave, edhe furnizimi me inventar shkollor për institucionet arsimore. Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë. Këtu vlen të përmendim si projekt shumë të rëndësishme që më në fund ka arritur të nënshkruar kontratën për vendosjen e kamerave të sigurisë. Vendosja me mirëmbajtjen e kamerave të sigurisë në zonën historike, vendosja e hidrantëve në zonën historike, blerja e dy motorëve malorë për brigadën e Zjarfiksëve, blerja e pajisjeve për brigadën e Zjarfiksëve edhe ndërtimi i mureve mbrojtëse. Janë mbajtur gjashtë takime me KKSBNë. Marrëveshja e bashkëpunimit me Policinë e Kosovës është nënshkruar dhe plani për vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera është hartuar. Drejtoria e Turizmit, ka pasur projektet kryesore kapitale me këtë rradhitje edhe disa janë proces të implementimit. Rregullimi i ambientit të jashtëm me fshatin Poslisht, ndërtimi i infrastrukturës së turizmit malor dhe rural në Nashec, Jablanicë, Vërmicë projekt dy vjeçar. Ndërtimi i infrastrukturës për turizëm kulturor në Leskovec, ndërtimi i infrastrukturës së rrugëve malore në rajonin e Sharrit. Zhupa, Zhuri, Vërmicë, Has dhe Kabashi, ndërtimi i infrastrukturës, kisha e Shën Pjetrit në Kabash të kështu me radhë. Po ashtu drejtoria ka realizuar dhe aktivitete të tjera, ndër më të rëndësishme janë organizimi i aktivitetit dimri kulturor, trajnimet profesionale në bashkëpunim me komunën e Konjës-Republika e Turqisë, trajnimi për filigran për zanat domethënë, panairi i turizmit ndërkombëtar është mbajtur në Prishtinë, edhe panairi ndërkombëtar i turizmit dhe i sportit si dhe panairi ndërkombëtar i turizmit ku ka marrë pjesë. Organizimi i panairit tradicional, pjesëmarrja në panairin e turizmit të Gastronomisë Global Albanian Gastronomic Festival i cila është mbajtur në Berlin të Gjermanisë.

Drejtoria e Shëndetësisë. Projektet kryesore kapitale të cilat janë implementuar dhe janë në implementim e sipër janë furnizimi me aparatura mjekësore, furnizimi me pajisje stomatologjike, furnizimi me mamogram, furnizimi me dy utoambulanca edhe ka përfunduar ndërtimi i QMF-së në fshatin Korishë. Në projektet kapitale që janë në vazhdim e sipër është ndërtimi i QMF-së të ish Kampi i KFOR-it dhe ndërtimi i QMF-së në lagjen e Trimave në Tusus. Po ashtu në kuadër të kategorisë së mallave dhe shërbimeve përveç projekteve që kanë të bëjnë me furnizim material të domosdoshëm për punën në rregull të QMF-së që është furnizimi me reagencë me filma RTG, furnizimi me material higjienik-sanitar të barna, furnizimi me material administrativ, uniformat e punës, vlen të cekim projektet ofrimi i shërbimeve shëndetësore për mbulimin e kërkesave dhe nevojës për staf shtesë në QMF, kontratën e nënshkruar me organizatën Caritas për pjesën e parë të vitit edhe mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve shëndetësore ku janë renovuar shumë njësi shëndetësore në të cilat janë përmirësuar kushtet e punës, siç janë QMFF në Zhur, AMF në Kushnin i Hasit, Skorbisht, Mushnikovë, Podrumi i ÇKMF-së e kështu me radhë. Po ashtu ka pasur trajnimi i profesionistëve shëndetësor për kujdesin parësor edhe reaktivizimi i vizitave sistematike për nxënës të shkollave të mesme dhe të ulëta. Aktivitete të tjera, dita botërore e kancerit, dita botërore e tuberkulozit, dita botërore e shëndetit, java botërore e imunizimit e kështu me radhë. Drejtoria për Punë dhe Mirëqënien Sociale i ka pasur këto projekte kapitale. Projekti i ndërtimit të banesave sociale në Petrovë -kulla 4 vazhdimimi i projektit, renovimi i banesave kolektive në Petrovë-kulla 3, ndërtimi i shtëpisë për të moshuar, furnizimi me inventar për shtëpinë e të moshuarve, ndërtimi i QPS 2, ndërtimi i shtëpive për fëmijët me vështirësi ekonomike në raste sociale, ndërtimi i kulmeve për familje skamnore, ndërtimi i shtëpive emergjente për mbrojtjen e fëmijëve, ndërtimi i qendrës rekreative sportive, blerja e veturës për shtëpinë e të moshuarve, blerja e veturës për shtëpinë rezidenciale. Projektet dhe aktivitetet të tjera të drejtorisë të realizuara dhe në realizim e sipër për vitin 2024 përfshijnë furnizimin me lëndë djekëse për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe raste të vështirësive ekonomike. Furnizim me pako ushqimore, me medikamente, me veshmbathje, blemja e frigoriferëve, televizorëve, shërbimi i transportit, për bartjen e fëmijëve dhe familjarëve të tyre me vështirësi sociale e kështu me radhë. Po ashtu, drejtoria gjatë vitit 2024 ka realizuar dhe subvencionimin i OJQ-ve dhe shtresave sociale në

nevojë. Diku 29 OJQ janë subvencionuar në vlerën totale prej 85 mijë eurove, subvencionimi i familjeve strehuese, subvencionimi i familjeve me vështirësi ekonomike për pagesën e qirasë. Ne paguajmë diku 11 familjeve qiranë për shkak se kanë probleme ekonomike, s'mund me i paguaj vetë. Gjatë vitit 2024 janë përpiluar disa dokumente shumë të rëndësishme, strategjia komunale për persona me aftësi të kufizuar edhe plani lokal i veprimit kundër dhunës në familje. Në komunën e Prizrenit pjesë e skemës sociale shfrytëzuese dhe ndihmës sociale momentalisht janë 626 familje me 2122 anëtarë. Gjithë ky raport është përpiluar duke u bazuar në të dhënat dhe informacionet që kemi marrë prej drejtorive edhe kemi tentuar me i paraqitur ato pikat kryesore edhe pse jam shumë i sigurt që ka pasur edhe shumë detaje të tjera të cilat nuk kanë mund me u përfshirë në raport për mos me qenë tepër i stërzgatur. Normalisht që të gjitha punët nuk kemi mund me i përfunduar, mirëpo shumë punë kanë përfunduar edhe një pjesë e tyre janë në vijim e sipër edhe jemi optimist se gjatë vitit të ardhshëm do të përfundojnë edhe ato që kanë mbetur edhe do të rrisim atë përqindjen e premtimeve të realizuara në mënyrë që si qytet, si qeverisje lokale, përfshi këtu edhe punën e asamblesë të dalim të suksesshëm. Se besoj që ju kam zgjatur shumë, por sidoqoftë ju falenderoj për vëmendjen. Në qoftëse keni ndonjë pyetje, ndonjë koment, ndonjë kritikë, urdhëroni.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): I nderuar kryetar, ju faleminderit shumë për këtë raport, për këto informata të hollësishme që na i sollet në kuvend. Në qoftëse dëshironi dikush në lidhje me këtë raport me e marrë fjalën? Po Petrit Hoxhaj fjalën e ka.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. Zakonisht raportet e mëdhaja a po din shumë kush i lexon mirëpo e kam lexuar me vëmendje deri në fund dhe kjo që dua me ta dhënë si sugjerim është që të shikon mundësinë e ndarjes së disa drejtorive sepse janë të mbingarkume. Është fjala për shembull Drejtoria e Shërbimeve Publike është e mbingarkume, është mirë që këtë me ndarë në dy pjesë. Së paku sektorin e ambientit, pse mos me ja dhënë Drejtorisë së Bujqësisë ose me bërë drejtori në vete me disa disa dikastere të tjera dhe besoj që kjo do të ishte më lehtë për këtë për këtë drejtori, sepse sa herë shkojmë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, i shohim të gjithë zyrtarët që janë të mbingarkuar me punë, janë të mbingarkuar me urdhëresa, dhe normal që mundet me pasur ndonjë lëshim do thotë ndonjë harresë të këtyre. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Petrit. Po urdhëro kryetar.

Shaqir Totaj (Kryetar i Komunës): Po dua me u ndërlidh këtu edhe po dua me thënë që është pikë jashtëzakonisht e qëllume edhe pse disa herë e kemi diskutuar mundësinë e riorganizimit komplet të drejtorive për shkak se kemi vlerësuar që ka nevojë. Për shembull Zyra e Pronës kemi dashur me bërë drejtori të veçantë. Mirëpo procedura për me i bëri këto punë ishte shumë birokratike. Edhe duhet një provim apo leje prej qeverisë, prej ministrisë konkrete edhe thjesht u dashke me harxhuar shumë energji edhe na pritoshim me i hy në një punë, me harxhuar aq shumë energji për diçka që ishte dashur me u kryer shumë lehtë. Edhe ka mbetur kështu qysh është, përndryshe, po pajtohen. Ne kemi pasur edhe ide të tjera, kemi pasur ide për shembull turizmin edhe zhvillimin ekonomik mbi nda, se turizmi kërkon një mendësi tjetër, një zhvillim ekonomik një mendësi tjetër. Kemi pas ide për shembull turizmin me lidhur me kulturën, e sportin edhe rininë me i lënë veç, por të gjitha këto po them marrin energji shumë për me realizuar në aspektin formal. Edhe për mos me orientuar shumë andej e me na mbetur punët pa kryer e me mbetur masnej tuj prodhu letra e strategji sikur qeveria që po prodhon, më mirë na ka marrë mendja me kryer ndonjë punë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Adriti fjalën e ka.

Adrit Krasniqi (PDK): Faleminderit kryesuese. Unë dashta me falenderu kryetarin për këtë raport të hollësishëm që e bëri para neve. Po ashtu edhe me përgëzuar për punën dhe përkushtimin e tij që e ka bërë gjatë këtyre 3 viteve bashkë me kabinetin e tij, ku dihet dhe shihet qartë se në çfarë gjendje e ka marrë komunën dhe ku e ka sjellë. Këto nuk është që po e themi ne, por po e thojnë organizata e ndryshme dhe ministritë relevante. Unë kisha me kërkuar prej kryetarit me vazhduar këtë tempo edhe kismet mandatin e dytë, patjetër.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Adrit. Dikush tjetër? Në qoftë se jo atëherë unë e falenderoj edhe kryetarin edhe juve për kontributin në këtë pikë. Po kalojmë te pika e radhës.

Pika e dhjetë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e planit rregullues të hollësishëm zona e parkut për industri të lehtë në Prizren Parku i Biznesit sipas hartës zonale të komunës së Prizrenit dhe sipas kërkesës së Ministrisë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtor fjala për juve është.

Pranverim Berisha (Drejtor i DUPH-së): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, të nderuar kolegë ekzekutiv, të nderuar kuvendarë dhe media. Faktikisht në atë që disa herë domethënë i kemi kaluar edhe të gjitha fazat për planin rregullues të rrehollësishëm për zonën ekonomike. Mirëpo Ministria ka pasur një kërkesë ku ka kërkuar që të respektohet udhëzimi administrative 2014 përkatësisht në nënin 12, ku thuhet se duhet të futet ose të kompletohet domethënë raporti i shqyrtimit publik. Prandaj ne në bazë të kërkesës së Ministrisë ju e keni edhe propozim-vendimin domethënë ku thuhet edhe në preambulë, sipas kërkesës e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, duhet të plotësohet dhe të bëhet pjesë e këtij vendimi raporti i shqyrtimit publik. Pra, aty edhe ku shkruan konsultim publik, fjala është për shqyrtim publik edhe te raporti edhe te procesi të bashkë. Prandaj është kërkesë e Ministrisë që ne jemi detyruar me respektuar dhe kështu që kërkoj nga ju kuvendarët që ta kryejmë edhe këtë formalitet, por që është kërkesë e Ministrisë edhe duhet ta respektojmë edhe me votën tuaj. Faleminderit.


Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. A ka dikush diçka me shtuar rreth kësaj pike? Ndnjë pyetje diçka? Në qoftëse jo, po e hedhim menjëherë në votim. Prezent jemi 21 anëtarë, kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit i ditës? 20 jemi për, 0 kundër dhe 1 abstenim, Atëherë miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Ju falenderoj. Kalojmë te pika e fundit që është propozuar sot.

Pika e njëmbëdhjetë

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtori veç e ka diskutuar kur e propozoi, nuk e di a keni nevojë përsëri? Në qoftëse jo atëherë po e hedhi në votim. Prezent jemi 21 anëtarë, kush është për që të miratohet edhe kjo pikë e rendit i ditës? Unanimisht me sa po e shoh, ju falenderoj të gjithëve. Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrje, ju uroj festat e fundvitit, të keni shëndet, begati dhe mirësi për ju dhe familjet e juaja. Mirupafshim në vitin tjetër.

Përfundoi në ora: 15:44



Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi